



KLINË

**Strategjia e veprimit
për komunitetin serb
në komunën e Klinës
2011 - 2013**

Strategjia e veprimit
për komunitetin serb
në komunën e Klinës
2010 - 2013



Publikuar nga:
OJQ "Syri i Vizionit"
Qendra Zejtare 64/B
30000 Pejë, Kosovë

Mendimet e shprehura ne këtë dokument paraqesin pikëpamjet e autorëve dhe jo domosdoshmërisht edhe qëndrimet e Syri i Vizionit, The Olof Palme Center dhe komunës së Klinës.

Botimi i këtij dokumenti është mundësuar nga The Olof Palme Center

Falënderime

Autorët e kësaj strategjie, organizata joqeveritare “Syri i Vizionit” falënderon gjithë bashkëpunëtorët, organizatat dhe individët që kanë ndihmuar në procesin e hartimit të këtij dokumenti.

Falënderim i parë është për Olof Palme Center për bashkëpunim të mirë dhe mbështetjen financiare që i ka dhënë këtij procesi.

Një falënderim i veçantë për komunën e Klinës, kryetarin Sokol Bashota, nënkryetarin Zenun Zeqa, shefin e Zyrës për komitete Millorad Sharkoviq dhe zyrtarin e kësaj zyre Ranko Kostiq si dhe Skënder Avdylin nga Drejtoria e shërbimeve publike në Pejë, që ka ndihmuar në përlogaritjen e kostos së projekteve.

Falënderimi tjetër është për përfaqësuesit e komunitetit serb të Klinës, kryesuesit e fshatrave, përfaqësuesit e organizatave të këtij komuniteti si dhe të gjithë ata që kanë marrë pjesë në takimet e mbajtura nëpër fshatra dhe lagje të komunës së Klinës dhe që me kërkesat, sugjerimet dhe propozimet e tyre kanë kontribuar që ky dokument të jetë më i plotë në përmbajtje dhe më i pasur me ide e propozime.

Falënderojmë: përfaqësuesit e fshatrave të cilët kanë marrë pjesë në takimet e këshillit të përbashkët të fshatrave: Radomir Mikiq, Milorad Sharkoviq, Ranko Kostiq, Mihajlo Çekrliq, Andrea Banjac, Slavko Dashiq, Zoran Bozhicq, Igor Donçiq, Dragoljub Peruniçiq, Radonja Magiq dhe Bozhidar Sharkoviq.

Falënderojmë anëtarët e fokus grupeve nëpër fshatra që kanë marrë pjesë në takime dhe trajnime: Nenad Stashiq, Ranko Kostiq, Ranko Biçanin, Aleksandar Sharkoviq, Dragana Kostiq, Marija Mishiq, Milorad Tomiq, Radoje Tomiq, Slavica Kostiq, Milan Trifunoviq (Videjë); Slavko Dashiq, Zoran Bozhicq, Zharko Shilkoviq, Radunka Dashiq, Dragomir Dashiq, Igor Dashiq, Borislav Dashiq, Radoica Dashiq, Gvozden Bozhicq dhe Smilja Vuliq i Borislav Dashiq (Rudice); Savo Banjac, Svetozar Pantiq, Miloje Vuçkoviq, Bogolub Jevtiq, Miloje Zhuniq, Milovan Zhuniq, Boban Zhivkoviq, Ljubinka Banjac, Milanka Mishiq, Krsto Banjac, Andreja Banjac, Budimka Zhivkoviq i Krsto Zhivkoviq (Berkovë); Dragan Peruniçiq, Mishko Vasiq, Danilo Donçiq, Stevan Donçiq, Danijela Donçiq, Dragoljub Peruniçiq dhe Miqqa Vasiq (Binçë); Zoran Arsiq, Vidoje Rajiq, Predrag Rajiq, Milladin Rajiq, Dimitrije Milloviq, Lubomir Rajiq, Bozhidar Sharkoviq, Branko Minkoviq, Radomir Baciq, Miloje Rajiq, Milan Sharkoviq e Sllobodan Baciq (Dolc); Katarina Magiq, Radonja Magiq, Millosav Toshicq, Radosh Magiq, Ilinka Neshiq, Milena Neshiq, Borka Koniq, Aleksandar Petroviq, Radomirka Magiq, Milijana Magiq e Jagoda Neshiq (Grabc); Milovan Karaxhiq, Radomir Dabizhljeviq, Mihajlo Çekrliq, Zhivko Ribaq, Borislav Çekrliq, Vukosav Ribaq, Vladimir Shmigiq, Miodrag Mikiq, Janiqije Ribaq, Svetozar Dabizhljeviq, Boshko Dabizhljeviq, Vlado Shmigiq, Zhivorad SHmigiq, Predrag Stoshicq, Zoran Ribaq, Marija Stoshicq, Zoran Stoshicq e Zhivko Stoshicq (Drnsnik) Marko Nedeljkoviq, Radoje Mikiq, Dobrivoje Peshiq, Radivoje Isailoviq, Milivoje Vukçeviq, Milan Gjoroviq, Lepasava Maziq, Ratko Peshiq, Milorad Isailoviq, Zhivan Maziq, Radomir Mikiq, Mihajlo Mikiq, Mirko Tomiq e Zhivorad Peshiq (qyteti Klinë)

Autorët e këtij dokumenti ndjejnë të nevojshme të sqarojnë se nëse në tekstin e kësaj strategjie nuk është përfshirë puna ose aktivitetet e të gjithë atyre që kanë punuar në këtë komunitet, kjo është e paqëllimshme. Poashtu kërkojmë falje për të gjitha ata që mendojnë se nuk janë përfshirë sa duhet kërkesat dhe sugjerimet e tyre dhe komunitetit të tyre.

Shkurtesat:

AED	- Academy for Educational Development
DRC	- Danish Refugees Council (këshilli danez për refugjatë)
ICMC	- International Catholic Migration Commission
IOM	- International Orgazation for Migration
KEK	- Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	- Kosovo Force
KPA/AKP	- Agjensioni Kosovar i Pronës
OJQ	- Organizatë Joqeveritare
OSBE	- Organizata e Sigurimit dhe Bashkëpunimit Evropian
PTK	- Post- Telekom i Kosovës
RRK	- Return and reintegration in Kosovo
RTK	- Radio televizioni i Kosovës
RTM	- Reggio Terzo Mondo
SiV	- Syri i Vizionit
SHKA	- Shoqëri kulturore artistike
THW	- Teshnisches Hilfswerk
UNDP	- United Nations Development Programme
UNHCR	- United Nations High Commissioner for refugees
UNMIK	- United Nations Mission in Kosovo
USAID	- United States Agency for International Development



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Komuna e Klinës në vazhdimësi është e angazhuar për krijimin e një shoqërie të barabartë, në të cilën të gjithë qytetarët do jenë të barabartë pavarësisht përkatësisë etnike, religjioze, etj. Komuna e Klinës iu ka bashkëngjitur të gjitha përpjekjeve për ndërtimin e një shoqërie shumetnike, ka përkrahur të gjitha nismat që kanë ardhur në këtë komunë dhe ka qenë pjesë e të gjitha projekteve të zhvilluara në Kosovë.

Ne kemi mirëpritur punën që ka bërë organizata joqeveritare "Syri i Vizionit" në përpilimin e strategjisë së veprimit për komunitetin serb në komunën e Klinës dhe e shohim si një kontribut për përmirësimin e gjendjes së këtij komuniteti.

Të gjithë së bashku mund të punojmë për ndërtimin e një shoqërie të qytetarëve të barabartë dhe një komune të zhvilluar.

Me respekt

Kryetari i Komunës së Klinës
Sokol Bashota



PËRMBAJTJA

5	Falënderime
6	Shkurtesat
7	Parathënie
9	Realizuesit
10	I. Hartimi i strategjisë
11	Çka është kjo strategji
11	Baza e hartimit të Strategjisë
11	Rruga që është ndjekur për hartimin e Strategjisë
12	Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të Strategjisë
12	Përfshirja e komunitetit në hartimin Strategjisë
13	Përfshirja e komunës në hartimin e Strategjisë
13	Gjendja aktuale
13	Shtrirja e komunitetit serb në komunën e Klinës
13	Gjendja në të cilën jeton komuniteti serb
14	Hulumtimi i kryer nga "Syri i Vizionit" për gjendjen e këtij komuniteti në komunën e Klinës
14	Gjendja e familjeve
15	Gjendja e objekteve të banimit
15	Qasja në shërbimet publike
16	Qasja
17	Zbatimi i Strategjisë
17	Vështirësitë në realizimin e kësaj strategjie
18	II. Iniciativat dhe rekomandimet
19	Hyrje
20	Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale
21	Edukim dhe rini
22	Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
24	Shëndetësia dhe çështjet sociale
24	Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
26	Kultura, mediat dhe informimi
27	Të drejtat e femrave
28	III. Ndërhyrja në komunitet
29	Hyrje
30	Projektet për qytetin e Klinës
32	Projektet për fshatin Dersnik
34	Projektet për fshatin Binça
37	Projektet për fshatin Bërkovë
39	Projektet për fshatin Rudice
41	Projektet për fshatin Dollc
44	Projektet për fshatin Videjë
46	Projektet për fshatin Grapc
50	IV. Buxheti
51	Tabela Buxhetore
52	V. Foto
53	Fotografi nga takimet me komunitetet

Olof Palme Center - Qendra Olof Palme



Olof Palme International Center punon në bashkëpunimin ndërkombëtar për zhvillimin dhe krijimin e opinionit publik i cili ka të bëjë me çështjet ndërkombëtare politike dhe ato të sigurisë.

Palme Center është themeluar në vitin 1992 nga Partia Social Demokrate e Suedisë, Konfederata e Sindikatës së Tregtisë dhe Sindikata Kooperative. Sot Palme Center ka 28 organizata anëtare brenda lëvizjes së punës.

Qendra punon sipas pikëpamjeve të jetës së Kryeministrit të ndjerë të Suedisë, Olof Palme, i vrarë në vitin 1986, të cilat reflektohen në citimin e famshëm: "Politika po dëshiron diçka. Politikën Social Demokratike po dëshirojnë ndryshime".

Bindja e Olof Palmes se siguria e përbashkët krijohet në bashkëpunim dhe solidaritet nëpërmes kufijve, përshkon aktivitetet e Qendrës.

Zotimi i këtyre organizatave anëtare është baza e aktiviteteve të Qendrës. Përveç organizatave themeltare, ato përfshijnë edhe Shoqatën Edukuese të Punëtorëve, lëvizjen e banorëve dhe sindikatat individuale. Si lëvizje të popullarizuara dhe organizata vullnetare, ato përfaqësohen në të gjitha komunat e Suedisë dhe në shumë vende pune. Një individ nuk mund të jetë anëtar i Palme Center, por organizatat anëtare së bashku kanë mbi tre milionë anëtarë.

Bashkëpunimi ndërkombëtar për zhvillim është i përqendruar në gjashtë rajone: Ballkan, Evropë Lindore dhe Rusi, Amerikë Latine, Lindje e Mesme, Azi Juglindore dhe Afrikë Jugore.

Palme Center dhe organizatat e saja anëtare përfshihen në afërsisht 450 projekte zhvillimore ndërkombëtare gjatë një viti. Ato shtrihen prej edukimit qytetar dhe strukturës organizative deri në projektet për të drejtat e njeriut dhe të pajtimit.

Qendra ka një kornizë marrëveshjeje me agjencinë Swedish International Development Co-operation Agency (SIDA), e cila financon projektet për zhvillim ndërkombëtar të organizatave anëtare. Shumica e projekteve zbatohen drejtpërsëdrejti nga organizatat anëtare, të cilat së bashku me partnerët e tyre lokal të bashkëpunimit janë përgjegjëse për planifikimin, inicimin dhe vlerësimin e projekteve. Kjo ndihmon që të krijohen lidhje shumë të fuqishme lokale. Qendra zbaton relativisht pak projekte të zhvillimit ndërkombëtar në vete, me përjashtim nga Ballkani.

Qendra gjithashtu administron fondin International Solidarity Fund (I-Fund), që është lëvizja e punës për solidaritet ndërkombëtar dhe bashkëpunim zhvillimor. Të gjitha mjetet e grumbulluara nga I-Fund përdoren ekskluzivisht për të mbështetur punën e zhvillimit të sindikatave dhe politikave.

Qendra është e bazuar në Stokholmin qendror.

OJQ "Syri i Vizionit"



Organizata Syri i Vizionit është regjistruar zyrtarisht si OJQ lokale në Shtator të vitit 2001, por ka filluar të funksionoj me herët që nga 1999 si Organizate e Bazuar në Komunitet (CBO) në komunën e Pejës, duke bërë koordinimin dhe publikimin e revistës për të rinj "Vizioni" në Kosovë me ndihmën financiare nga USAID-i. Pas aktiviteteve rinore, SiV ka arritur të zgjerojë angazhimin e saj dhe me kalimin e viteve ka rritur profesionalizëm në implementimin e projekteve të një spektri të

gjerë, duke e dëshmuar veten si pjesëmarrës aktiv të shoqërisë civile në Kosovë.

Përgjatë viteve të fundit, OJQ "Syri i Vizionit" ka zhvilluar partneritete të shumta me një spektër të gjerë të organizatave lokale dhe ndërkombëtare, komunave dhe faktorëve tjerë aktivë në Kosovë dhe Ballkan si: Komisioni Evropian, USAID, KFOS, ATRC, IREX, DRC, CARE International, OSCE, Olof Palme, Swiss Labour Assistance, etj.

Në dhjetë vjet të aktivitetit, organizata është pjesë e partneriteteve, rrjeteve lokale dhe rajonale të shoqërisë civile, dhe pjesëmarrës i fushatave të ndryshme që kanë forcuar rolin e shoqërisë civile dhe zërin e qytetarët karshi institucioneve. Nga viti 2003, organizata është një nga partnerët zyrtar të Web Portalit One World për Evropën Juglindore, nga 2004, SiV është anëtar aktiv i KIP- Programi i Iniciativës Kosovare. Në mënyrë aktive organizata është pjesë e Platformës Pro Peace e lansuar në Kosovë me iniciativën e OJQ-ve lokale në 2005. Nga viti 2007 SiV është pjesë e Koalicionit për Parlament të Pastër, Koalicionit "Demokracia në Veprim" që merret me monitorimin zgjedhjeve, Rrjetit për Siguri, Koalicionit për Bashkëpunim në mes Shoqërisë Civile dhe Qeverisë, Konsorsiumit të shoqërisë civile për monitorimin e parlamentit të Kosovës, etj.

OJQ "Syri i Vizionit" kryesisht ka për qëllim promovimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në Kosovë, me fokusim në regjionin e Pejës. Në përpjekjet e vazhdueshme për të implementuar praktika demokratike, SiV i jep rol të veçantë promovimit të qeverisjes së mirë, përgjegjësisë, transparencës dhe pjesëmarrjes në sferat e ndryshme të shoqërisë civile.

Në praktikë, çfarëdo projekti i implementuar nga SiV kërkon për të themeluar lidhje të vazhdueshme në mes të autoriteteve komunale dhe akterëve të shoqërisë civile në nivel individual ose institucional.

Që nga fillimi, SiV ka artikuluar punën e saj rreth objektivave specifike si:

- Zhvillimi i përgatitjes dhe përhapjes së informative të besueshme dhe të sakta tek qytetarët;
- Promovimi i vetëdijes publike lidhur me problemet urgjente sociale tek masa e gjerë, nëpërmjet veprimeve që rrisin vetëdijen;
- Pajisja e qytetarëve me mjaft avokim/mbrojtje, si dhe aftësi për lobizim dhe punë ekipore/ të rrjetëzuar në mënyrë që t'i praktikojnë të drejtat e tyre elementare dhe të mund të sfidojnë institucionet qeveritare.



I. Hartimi i strategjisë

1.2 Baza e hartimit të Strategjisë

Strategjinë e veprimit në komunitetin serb është në përputhje me dokumentet komunale, strategjitë komunale për kthim dhe integrim dhe me përkushtimin e Kuvendit Komunal të Klinës për veprimin në komunitetin serb. Strategjia mbështetet në orientimin e popullit dhe institucioneve të Kosovës për të ndërtuar një shoqëri të barabartë, për të përkrahur procesin e kthimit dhe integritit. Dokumenti poashtu është në përputhje edhe me dokumente tjera ndërkombëtare për trajtimin e pakicave dhe për qasje afirmative ndaj këtij komuniteti.

Pasi kjo strategji është e hartuar në bashkëpunimin mes komunës, komunitetit serb dhe pjesëmarrësve tjerë me rëndësi në këtë proces, ky dokument do të jetë në shërbim të komunës, që ta shfrytëzojë sipas nevojës ose ta shndërron në dokument pune për komunën për periudhën në vazhdim, ose ta paraqesë para donatorëve që mund të shprehin interesim për të vepruar në komunitet.

1.3 Rruga që është ndjekur për hartimin e strategjisë

Strategjia është hartuar pas një pune një vjeçare, që OJQ Syri i Vizionit (SiV) ka bërë bashkë me komunitetin serb, përfaqësuesit e lokaliteteve të banuara nga komuniteti, aktivistëve të komunitetit si dhe Komunës së Klinës.

Fillimisht "Syri i Vizionit" ka vizituar komunitetin në të gjitha lokalitetet ku jeton ai dhe ka mbledhur të dhënat për jetën dhe gjendjen në të cilën jeton ky komunitet, për të pasur një pasqyrë më të mirë. Në mungesë të studimeve të mëparshme, në fazën e parë është bërë një hulumtim për të parë gjendjen me shifra dhe fakte konkrete. Hulumtimi është kryer në lokalitetet kryesore ku jeton komuniteti serb dhe ka qenë i fokusuar në pikat kryesore për të zbuluar gjendjen e familjeve dhe shtëpive në radhët e këtij komuniteti.

Pas kësaj në lokalitet më të mëdha në komunën e Klinës janë krijuar fokus grupet me pjesëtarë të komunitetit dhe është krijuar një strukturë e njerëzve në terren me të cilët "Syri i Vizionit" ka punuar dhe ka kontaktuar gjatë gjithë hartimit të projektit. Fokus grupet në fillim janë krijuar në fshatrat Grapc, Binçë, Dollc, Rudicë, Bërkovë, Dersnik, Videjë dhe në qytetin e Klinës.

1.1 Çka është kjo strategji

Strategjia e veprimit për komunitetin serb në komunën e Klinës (në tekstin e mëposhtëm Strategjia) është dokument që synon të parashtrijë gjithë problematikën që ka komuniteti serb në komunën e Klinës. Ajo përmbledh nevojat dhe kërkesat e këtij komuniteti në lokalitete ku jeton në gjithë territorin e komunës, duke përfshirë problemet e tyre jetësore, kërkesat e komunitetit dhe zonës në të cilën jeton dhe parashtron orientimet e ardhshme të punës në këtë komunitet në këto tri vjet.

Si i tillë ky dokument është një bazë e mirë për komunën, donatorët dhe komunitetin në të ardhmen. Aty janë paraqitur gjithë problematikat, ndarë në sektorë të ndryshëm, janë ofruar zgjedhjet e mundshme dhe është bërë një përlllogaritje e përafërt e kostos së aksionit të veprimit në këtë komunitet. Në këtë mënyrë Strategjia përbën një plan aksioni dhe aktiviteti, ajo ndërthet në vete nevojat e komunës dhe komuniteteve.

Strategjia është hartuar nga OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja në bashkëpunim me komunitetin, përfaqësuesit e fshatrave dhe lokaliteteve si dhe me komunën, zyrtarët komunalë për komunitete. Projekti është financuar nga Olof Palme Center.

Projekti është një pilot projekt që synon të mobilizojë dhe trajtojë komunitetin serb që të t'i ndihmojë ata në avokim më të mirë në mënyrë që ata të jenë pjesëmarrës në ndryshimet në jetën e tyre dhe në vendimmarrje. Me projektet që parasheh kjo strategji mendohet të përmirësojë kushtet e jetës së komunitetit serb, komunitet që në dhjetë vjetët e fundit në një pjesë të lokaliteteve ka jetuar i papërfshirë në zhvillimet në komunën e Klinës dhe pa shumë komunikim me komunitetin shumicë shqiptar.

Me këto fokus grupe janë zhvilluar takime nëpër secilin fshat e lagje, në të cilat është diskutuar për temat sipas shtatë problematikave të caktuara. Kanë qenë shtatë sektorë sipas të cilave është diskutuar dhe janë kërkuar rrugët e zgjidhjeve: Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale; Edukim dhe rini; Punësimi dhe zhvillimi ekonomik; Shëndetësia dhe çështjet sociale; siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi; Kultura, mediat dhe informimi; Të drejtat e femrave. Pasi i është prezantuar komunitetit projekti, është kërkuar pjesëmarrja e tij aktive me sugjerimet dhe kërkesat, që ka ai, pasi në vendet e tyre anëtarët e komunitetit i dinë më së miri problemet dhe nevojat e veta.

Takimet janë mbajtura në secilin lokalitet, në lagje e në fshatra. Në këto takime janë marrë kërkesat e para, që përbëjnë bazën e parë për hartimin e planit të aksionit. Janë mbajtur dhjetëra takime me grupet, por edhe shumë takime me individuale dhe në grupe më të vogla me përfaqësues të komuniteteve.

Për të aftësuar komunitetet që në mënyrë sa më të mirë të dinë të parashtrojë kërkesat e veta, rrugët e prezantimit dhe avokimin e mëtejshëm, për përfaqësuesit e komuniteteve janë mbajtur tri herë trajnime nga ekspertë për evokim, për draftimin e strategjisë dhe për hartimin e projekt-propozimeve. Në trajnimin e parë (gjatë muajit maj 2010) ata janë aftësuar për të identifikuar problemet në komunitetin ku jetojnë dhe të gjejnë mënyrat e avokimit deri në realizimin projekteve të tyre. Në trajnimin e dytë të njëjtin muaj përfaqësuesit e komunitetit serb janë aftësuar për hartimin e projekt-propozimeve. Trajnimi i tretë për draftimin e strategjisë është mbajtur në muajin maj dhe me përfaqësuesit e komunitetit është dakorduar që të përgatisin ata vet dokumentet që do jenë pjesë e strategjisë.

Pas kësaj janë mbajtur takime të përbashkëta me përfaqësuesit e fokus grupeve nga fshatrat Grapc, Binçë, Dollc, Rudicë, Bërkovë, Dersnik, Videjë dhe në qytetin e Klinës, takime në të ashtuquajturin "këshill të përbashkët të komunitetit", me të cilët është punuar kapitull për kapitull në hartimin e strategjisë. Në këto takime kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të komunës nga Zyrat për komunitete. Strategjia në formën përfundimtare është e bazuar në gjithë materialin e mbledhur në këto dhjetëra takime me komunitetin si dhe kërkesat që në veti ka bërë secili lokalitet. Ajo është hartuar nga "Syri i Vizionit", ndërsa para botimit i është dhënë në shikim dhe diskutim përfaqësuesve të komunitetit në secilin lokalitet dhe komunës.

1.4 Pjesëmarrësit në procesin e hartimit të strategjisë

Projekti për hartimin e strategjisë së veprimit për komunitetin serb është udhëhequr nga OJO "Syri i Vizionit" nga Peja, ndërsa është financuar nga Olof Palme Center. Strategjia në këtë gjendje është rezultat i punës së përbashkët që është bërë gjatë një viti mes "Syrit të Vizionit" dhe pjesëmarrësve tjerë, komunitetit, organizatave të komunitetit dhe komunës.

Komuniteti ka qenë i kyçur në mënyrë aktive dhe kreative gjatë gjithë kohës në projekt. Secili lokalitet ka pasur fokus grupet e veta, grupe prej 7-10 vetash, që në disa takime të mbajtura kanë dhënë sugjerimet dhe idetë e veta. Për të qenë më aktiv në pjesëmarrje përfaqësuesit e secilit lokalitet kanë ndjekur edhe trajnimet përkatëse për hartim të projekteve dhe për avokim. Sugjerime e mbledhura nga përfaqësuesit e komunitetit janë përfshirë në draftin e strategjisë, i cili pastaj përsëri në atë formë është analizuar dhe plotësuar me shtesat, sugjerimet dhe kërkesat e komunitetit.

Komuna e Klinës ka qenë poashtu gjatë gjithë kohës pjesë e punës, pasi ata kanë marrë pjesë në gjithë procesin, duke filluar nga informatat e para që janë marrë nga komuna, nëpër takimet në terren, në trajnime dhe deri në shikimin e variantit përfundimtar.

1.4.1 Përfshirja e komunitetit në hartimin strategjisë

Komuniteti kanë qenë i kyçur në mënyrë aktive dhe kreative gjatë gjithë kohës në projekt në disa mënyrë:

- Komuniteti është përfshirë direkt në hartimin e strategjisë gjatë takimeve të mbajtura nëpër lokalitetet. Në secilin nga lokalitetet që ka një numër të konsiderueshëm të banorëve janë mbajtur nga disa takime.

- Përfaqësuesit e komunitetit kanë marrë pjesë në takimet e "këshillit të përbashkët të komunitetit", takime të mbajtura në Klinë në të cilat është folur për problemet sipas fushave të përcaktuara.

- Gjatë hartimit të strategjisë janë takuar përfaqësuesit e komunitetit të mbledhur në fokus grupe të fshatrave, organizatat joqeveritare dhe grupimet tjera që përfaqësojnë komunitetet.

1.4.2 Përfshirja e komunës në hartimin e strategjisë

Që nga fillimi i zbatimit të projektit janë mbajtur kontakte me komunën. Kryetari i komunës në dy takimet e para është informuar për procesion e paraparë për hartimin e strategjisë dhe ai ka marrë rol aktiv për të ngarkuar personat përkatës për bashkëpunimin dhe ndihmën e mëtejme gjatë gjithë procesit. Pas kësaj bashkëpunimi kryesisht ka shkuar përmes Zyrës për komunitete. Ky bashkëpunim ka qenë shumë i rëndësishëm për "Syri e vizionit" që ka përfituar nga përvoja dhe puna e bërë më parë nga Komuna në këtë komunitet.

Përveç se ka ndihmuar në rolin këshillues, Zyra ka qenë pjesëmarrëse në shumicën e aktiviteteve që janë zhvilluar përgjatë rrjedhës së projektit, në fazën kur është prezantuar projekti, në trajnime pastaj edhe në takime të "këshillit të komuniteteve" dhe në shikimin e draftit përfundimtar.

Strategjia në formën e draftit para shtypjes së saj i është dorëzuar komunës, kryetarit të komunës, Drejtorisë së Administratës dhe Zyrës për komunitete për të dhënë sugjerimet, për të plotësuar apo shtuar diçka në formën përfundimtare.

1.5 Gjendja aktuale

1.5.1 Shtrirja e komunitetit serb në komunën e Klinës

Komuniteti serb para luftës ka banuar pothuaj se në çdo pjesë të qytetit dhe fshatrave. Në disa fshatra përreth qytetit të Klinës ky komunitet ka përbërë edhe shumicën e popullsisë si për shembull në Videjë, Grapc, Binëë, Dersnik, Bërkovë, Dollc, etj ndërsa në fshatra tjera kanë qenë të përziera dhe komuniteti serb ka bashkëjetuar me komunitetet tjera si në Rudicë, KLinavc, Dugajevë, Budisalc, Grmnik, etj. Edhe pse një numër i madh i këtij komuniteti ka jetuar në qytet, shumica e tyre edhe sot posedojnë tokat bujqësore të kualitetit të lartë në fshatrat apo në periferi të qytetit të Klinës dhe ky komunitet njihet si shumë punëtor dhe i vyeshëm posaçërisht në blegtori dhe bujqësi.

Gjatë luftës së fundit gjithë popullata është shpërngulur jashtë Kosovës në Mal të Zi apo Serbi, ose janë zhvendosur në veri të Kosovës. Kthimi ka filluar nga viti 2001 dhe ka qenë në fillim i organizuar kryesisht në vendet ku ky komunitet ka përbërë shumicën e popullsisë si në Binçë e Grapc p.sh. dhe ku

siguria ka qenë në nivel më të lart. Ndërsa tani çdo ditë më tepër po intensifikohet edhe kthimi spontan e po ashtu edhe në vendet ku gravitimi i këtij komuniteti ka qenë në një numër më të vogël si p.sh. nëpër lagjet e ndryshme të qytetit si dhe fshatrat përreth etj.

Deri më tani janë ndërtuar 350 shtëpi në të gjitha fshatrat dhe lagjet e komunës së Klinës. Por një pjesë e madhe e këtyre shtëpive të ndërtuara mbetet e pabanuar.

Përderisa në Kosovë nuk ka shifra zyrtare të regjistrimit të popullsisë momentalisht në dispozicion ka shifra të ndryshme. Në këtë dokument për krahasime dhe nevoja të parashtrimit të gjendjes janë përdorur shifrat e përafërta nga UNHCR si një institucion kredibil, kompetent dhe i paanshëm, si dhe shifrat që ka nxjerrë vet në terren "Syri i Vizionit".

1.5.2 Gjendja në të cilën jeton komuniteti serb

Ky komunitet jeton në lokalitete të ndryshme të qytetit, në pjesën urbane e po ashtu edhe në zonat rurale. Ndryshimet politike kanë bërë që ata të humbin vendet e punës që i mbanin në administratë, polici e gjykata, kurse privatizimi i fabrikave ka lënë punëtorët pa mundësi kthimi në vendet e punës. Tash një pjesë e mirë e tyre janë të pa punë dhe marrin asistencë sociale ose pensione. Kohët e fundit dallohen iniciativat e ndryshme të punimit të tokave pjellore që i posedojnë duke u përshtatur me gjendjen ekzistuese të papunësisë së madhe në komunë. Në sektorin e bujqësisë ata nga donatorë vendorë dhe të huaj janë ndihmuar shumë me mjete dhe makineri si dhe me fondin blegtoral. Sa i përket infrastrukturës ky komitet para luftës ka qenë i favorizuar me investime nga shteti, dhe kryesisht ka rrugë të asfaltuara objekte shkollash, ambulanca, shtëpi kulture, etj. Përveç atyre që jetojnë në qytet, ku ka më shumë shtëpi të vjetra, në vendet tjera ku janë kthyer, ata kanë shtëpi të reja, në të cilën jetojnë familje me numër të vogël anëtarësh. Në gjithë këto vende jetojnë kryesisht kryefamiljarë, të moshuar që mbajnë shtëpitë dhe tokat e tyre, kurse të rinjtë gjithnjë e më pak pranojnë të kthehen në mungesë të perspektivës edhe për shkak të varfërisë në Kosovë, edhe për shkak se nuk e gjejnë perspektivën në jetën e fshatit.

Sa i përket organizimit të jetës në komunitet ekzistojnë dy struktura të pushtetit, ato

kosovare dhe ato të Serbisë. Kështu ekzistojnë strukturat kosovare të arsimit, shëndetësisë, higjienës por edhe të njëjtat të Serbisë. Shumë herë është e njëjta strukturë e njerëzve që është pjesë e të dy sistemeve të financimit dhe ndarjes së përgjegjësisë. Gjatë vjetëve të kaluara këto struktura herë janë forcuar, herë janë dobësuar, por kanë qenë gjithnjë të pranishme.

Komuniteti ka përfituar nga të dy strukturat e pushtetit në paga, projekte, etj. edhe pse nuk i ka kryer obligimet ndaj asnjërit. Komuniteti nuk paguan tatim në pronë, nuk paguan rrymën, ujin dhe shërbime tjera.

Organizimi shoqëror i komunitetit është në nivel të ultë. Një pjesë e mirë e këtij komuniteti edhe në mungesë të përvojës, edhe për mosnjohje të rrjedhave dhe ndryshimeve që kanë ndodhur vjetëve të fundit në Kosovë, ka mbetur jashtë përfshirjes në çfarëdo rrjedhe të jetës shoqërore në komunë. Arsyet politike kanë pasur gjithnjë një ndikim në përfshirjen e këtij komuniteti në jetën shoqërore dhe vazhdojnë të kenë përsëri ndikimin e vet. Nga strukturat komunale dhe qendrore të qeverisjes kosovare ka pasur ftesa të vazhdueshme për t'u përfshirë në procesin politik në Kosovë dhe në komunën e Klinës. Dialogu ndëretnik dhe integrimi i komunitet mbeten një kërkesë e vazhdueshme në të cilën duhet të punojë shoqëria kosovare. Viteve të fundit edhe në kuadër të vet komuniteti ka një qasje më aprovuese në këtë drejtim.

1.6 Hulumtimi i kryer nga "Syri i Vizionit" për gjendjen e këtij komuniteti në komunën e Klinës

OJQ "Syri i Vizionit" gjatë muajit prill të vitit 2010 ka bërë një hulumtim për gjendjen e komunitetit serb në komunën e Klinës. Intervistat e bëra nga hulumtuesit nga OJQ "Syri i Vizionit" kanë mbledhur informacione për gjendjen e familjeve të këtij komuniteti dhe objekteve të banimit. Hulumtimi është kryer në tetë lokalitetet e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb: Dollc, Grabc, Binçë, Dersnik, Bërkovë, Rudicë, Videjë dhe në qytetin e Klinës. Në këto vende janë intervistuar 100 familje, nga të cilat intervistuesit kanë marrë të dhënat e përgjithshme dhe ato në tematika të veçanta. Të intervistuarit u janë përgjigjur pyetjeve për numrin e anëtarëve në familje, moshën dhe gjininë e tyre, gjendjen ekonomike-punësimin, të ardhurat, pasurinë dhe pronat. Poashtu në pyetësorët për gjendjen e shtëpive/objekteve

të tyre banimit gjatë intervistimeve janë mbledhur të dhënat për madhësinë e shtëpive dhe hapësirën për jetesë për familjet, kohën dhe kushtet e ndërtimit, pajisjen e shtëpive me pajisjet, etj.

Intervistimi jep një pasqyrë të plotë të gjendjes dhe kushteve në të cilat jeton komuniteti, një pasqyrë kaq të hollësishme nuk e ka bërë asnjë institucion më parë, duke nxjerrë të dhëna të saktësuara për komunitetin dhe kushtet në të cilat jeton. Hulumtimi ka një mangësi lidhur me numrin banorëve për faktin se intervistuesit kanë dhënë jo gjendjen reale në familjet e tyre, por kanë përfshirë aty edhe anëtarë të familjes që momentalisht jetojnë jashtë Kosovës.

1.6.1 Gjendja e familjeve

Në këto tetë lokalitete të komunës janë kryer 100 intervista me qytetarë që jetojnë aty. Rezultati ka treguar se nga familjet e intervistuar del se familja mesatare ka përafërsisht 3.1 anëtarë për familje, 71% të familjeve të intervistuar e përbëjnë moshë prej 24 deri 64 vjet.

Sa i përket nivelit të shkollimit hulumtimi nxjerr në pah se 59 përqind e popullatës ka vetëm arsim fillor, kurse 9 përqind kanë arsimim të lartë.

Në temat për punësimin rezultati është se 88 përqind e të intervistuarve nga moshë 18-64 nuk punojnë, 1 përqind deklarohen se janë vetë punësuar, kurse të punësuar janë 11 përqind.

Në të hyrat familjare 38 përqind vijnë nga rrogat, 60 përqind nga asistenca sociale, kurse 2 përqind nga diaspora. Nga shumat e deklaruara për hyrjet mujore del që 38 përqind kanë të ardhura prej mbi 100 e deri mbi 300 euro, 46 përqind kanë më pak se 100 euro në muaj.

Automjete të motorizuara në posedim të familjeve të intervistuar janë deklaruar që 92 përqind nuk kanë në posedim asnjë automjet.

1.6.2 Gjendja e objekteve të banimit

Sa i përket gjendjes së banimit, intervistimi ka nxjerrë në pah se gjatë luftës 76 përqind e shtëpive kanë pasur dëmtime të kategorinë V, kurse 20 përqind e shtëpive të tyre nuk janë dëmtuar ose kanë pësuar dëmtime të vogla.

Shumica e shtëpive (80 përqind) janë njëkatëshe, kurse nga të intervistuarit 99 përqind e shtëpive kanë kualitet të mirë ndërtimi. Sa i përket shfrytëzimit 75 % e shtëpive janë deri në 100 metra katrore. Sa i përket lejeve të ndërtimit, 99 përqind deklarohen që kanë leje ndërtimi, kurse vetëm 1 përqind nuk kanë pëlqim urban në shfrytëzim.

Sa i përket shërbimeve komunale ka një qasje të kufizuar për familjet e këtij komuniteti. 99 përqind të komunitetit shfrytëzojnë drurin për ngrohje. Intervistimi nxjerr në pah se 99 përqind nuk kanë telefona fiks, por 73 përqind shfrytëzojnë telefona mobil; 69 përqind janë të lidhur me ujësjellësin e qytetit, kurse 64 përqind që nuk kanë kanalizime por përdorin gropat septike. Në këtë komunitet 64 përqind përdorin deponi ilegale për grumbullimin e mbeturinave. Për dallim nga shërbimet, përgjigjja ndaj obligimeve është e vogël: 84 % e të intervistuarve deklarojnë se nuk paguajnë tatim në pronë.

1.7 Qasja në shërbimet publike

Varësisht nga lokaliteti ku jetojnë pjesëtarët e komunitetit serb kanë qasje në shërbimet publike të institucioneve të Kosovës, por edhe atyre të Qeverisë së Serbisë në Kosovë. Në disa vende ata kanë qasje në shërbimet publike të të dy pushteteve. Ata ndjekin mësimet në shkollat e veçanta për serbët, të financuar nga Republika e Serbisë. Prej këtij viti kjo bëhet vetëm në fshatin Videjë, ku ata kanë shkollën tetëvjeçare, kurse deri vitin e kaluar kishte edhe një shkollë në Binçë, që është mbyllur në mungesë të nxënësve. Në fshatin Videjë ata ndjekin mësimet në shkollën tetëvjeçare, ndërsa pas kësaj ndjekin shkollën e mesme në fshatin fqinj Osojan të komunës së Istogut, ku përveç shkollës fillore funksionon edhe shkolla e mesme në drejtimet gjimnaz dhe teknike, me financim po nga Qeveria e Serbisë. Deri para tri vjetësh këto shkolla janë financuar edhe nga qeveria e Kosovës, kur Qeveria e Serbisë u ka kushtëzuar mësimdhënësve të përcaktohen se në cilin sistem arsimor do marrin pjesë. nxënësit nga fshatrat tjera e

kanë të siguar udhëtimin për në këto shkolla.

Shërbimet shëndetësore poashtu komuniteti serb i ka të organizuara nga ana e autoriteteve serbe. Në këtë aspekt nuk ka ndonjë objekt kryesor të këtyre strukturave, edhe pse ka personel të angazhuar në Binçë, Dersnik dhe Videjë, kurse ndihmën e shpejtë mjekësore e marrin edhe në ambulancat e afërta kosovare dhe në Spitalin e Klinës. Sa i përket shërbimeve sociale pjesëtarët e komunitetit gëzojnë të njëjtat kushte si gjithë qytetarët e Kosovës. Lidhur me punësimin në institucionet komunale dhe shtetërore, komuniteti ka një numër shumë të vogël të të punësuarve vetëm 3 vetë në institucionet kosovare, por ka një numër të madh të punësuarve në strukturat e pushtetit serb në Kosovë.

Në aspektin e përfaqësimit, serbët për shkak të mos daljes së deritanishme në zgjedhjet lokale nuk kanë përfaqësues në Kuvendin Komunal të Klinës, por janë të përfaqësuar nëpër komitetet e Kuvendit. Në Kuvendin e Kosovës, 20 vende janë të rezervuara për komunitet pakicë në Kosovë-dhjetë për serbët.

Problemet e banimit, pronave dhe vendbanimeve joformale nuk janë probleme me të cilat ndeshet komuniteti. Vendbanimet kanë kryesisht infrastrukturë të zhvilluar në krahasim me fshatrat tjera.

Çështja e sigurisë paraqet një problem i cili është tashmë i tejkaluar në këtë komunitet kudo që jeton në komunën e Klinës. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve kanë lirinë dhe sigurinë si dhe e shprehin pa ndonjë pengesë përkatësinë tyre etnike dhe fetare. Komuniteti ka asnjë medium informimi lokal, ndërsa informimin e marrin nga mediat nga Beogradi. Për problematikat e tyre është shkruar mjaft nga media në gjuhën shqipe, me një qasje që posaçërisht vjetëve të fundit kryesisht është pozitive dhe afirmuese.

1.8 Qasja

Strategjia i qaset komunitetit në mënyrë afirmative. Qëllimi i kësaj strategjie është të afirmojë veprimin pozitiv në raport me komunitetin, në përputhje me orientimet evropiane për veprimin me komunitetet pakicë si dhe në koordinim me politikën e Qeverisë së Kosovës karshi komuniteteve pakicë në Kosovë.

Nga ana formale, problematikave të komuniteteve strategjia iu ka qasur në dy mënyrë: me qasjen në përgjithësi dhe sipas lokaliteteve të veçanta. Qasja e parë ka të

bëjë më kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me komunitetin në përgjithësi kudo që jeton brenda komunës së Klinës. Në këtë pjesë bëhet fjalë për tematika të tilla që s'lidhen me lokalitetin por janë nevoja të përbashkëta për të gjithë komunitetin. Aty hyjnë kërkesat për përdorimin e gjuhës serbe, informimin, përfaqësimin politik, procesin e kthimit dhe integritimit, etj. nga të cilat përfiton gjithë komuniteti në secilin lokalitet, përfshirë edhe lokalitetet më vogla në të cilat ka vetëm disa familje.

Strategjia është e mbështetur në debatet me komunitetet orientuar në shtatë tema kryesore të konsideruara si më të rëndësishme për komunitetet:

1. Shtëpitë, çështjet pronësore, vendbanimet joformale
2. Edukimi dhe rinia
3. Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
4. Shëndetësia dhe çështjet sociale
5. Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
6. Kultura, mediat dhe informimi
7. Të drejtat e femrave

Qasja sipas lokaliteteve të ndryshme ka të bëjë me projekte të veçanta. Kryesisht më të shpeshta në këtë pjesë janë projektet për infrastrukturën, projektet e bujqësisë, zhvillimit ekonomik, etj.

Në këtë pjesë gjatë hartimit të strategjisë, bashkë me komunitetin, "Syri i Vizionit" ka tentuar të bëjë edhe përlllogaritjen e përafërt të kostos së implikimit buxhetor për projektet e veçanta. Në këtë mënyrë këto kërkesa të komunitetit kanë marrë formën e mini projekteve, në të cilat sipas një modeli të përbashkët janë përcaktuar disa kërkesa si kostoja e përafërt e llogaritur e çmimit, objektivat dhe qëllimet, përfituesit, etj. Këto të dhëna janë konsideruar si pasqyrë e parë për t'u paraqitur para komunës dhe donatorëve për të matur mundësinë e angazhimit financiar.

1.9 Zbatimi i strategjisë

Ky dokument u adresohet të gjithë institucioneve, organizatave dhe atyre që janë të interesuar për të punuar me komunitetin serb në komunën e Klinës. Megjithatë, në radhë të parë Strategjia është hartuar për të qenë në dispozicion të komunës dhe komunitetit, për nevojat e planifikimit, ndërhyrjes në këtë komunitet dhe për të qenë në dispozicion për donatorët. Strategjia në formën e tillë të hartuar ofron një pasqyrë të gjendjes në terren, kërkesat e

komunitetit dhe jep sugjerime për projektet dhe drejtimet e mundshme të zhvillimit dhe investimit në periudhën trevjeçare në vazhdim. Ajo mund të shfrytëzohet nga zyrtarët komunalë në takimet me donatorët të cilët mund të shohin vendin se ku mund të kyçen për të ndihmuar komunën dhe komunitetin.

Me përcaktimin e kërkesave/ projekteve Strategjia jep edhe një përlllogaritje të përafërt të kostos së ndërhyrjes, kështu që paraqet një tregues të mirë të nevojave të implikimeve buxhetore për vetë komunën ose donatorët, në mënyrë që ata të kenë mundësi të matin mundësitë e tyre dhe angazhimit të tyre në komunitete.

Ajo është një dokument në dispozicion posaçërisht për vetë komunitetin, përfaqësuesit e tyre, qoftë në institucionet politike, qoftë në shoqërisë civile për të kërkuar projekte dhe zhvillimin e komunitetit. Ajo do të jetë një dokument i rëndësishëm që pasqyron gjendjen e tërësishme të komunitetit të tyre, mundësitë dhe perspektivat.

1.10 Vështirësitë në realizimin e kësaj strategjie

Autorët e strategjisë e kuptojnë që gjitha rekomandimet dhe sugjerimet që dalin nga ky dokument nuk mund të plotësohen përnjëherë, as në një periudhë të shkurtë. Ato mbasin si orientime të vazhdueshme për institucionet dhe shoqërinë në një periudhë afatmesme dhe afatgjate. Por disa nga kërkesat sipas sektorëve dhe disa nga projektet dallohen për urgjencën me të cilën duhet ndërhyrë në to. Prioritet në këtë aspekt paraqitet nevoja për integrimin e komunitetit, nxitjen e dialogut ndër fqinjësor, punësimin, aktivizimin e rinisë, ngjalljen e jetës në fshatrat ku është bërë kthimi, shtimin e të kthyerve në pjesën urbane dhe ruajtjen e pasurisë. Këto kërkojnë ndërhyje më të shpejtë, ndërsa edhe sektorët tjerë janë poaq të rëndësishëm dhe me nevojën që sa më parë të veprohet në to.

Autorët e strategjisë janë të vetëdijshëm për disa vështirësi që do të ndikojnë në realizimin e kësaj strategjie. Vështirësi kryesore në këso raste janë mungesa e mjeteve financiare për plotësimin dhe jetësimin e nevojave që ka komuniteti. Komuniteti serb në lokalitetet ku jeton kanë nevojë për ndryshime të mëdha qoftë në mënyrën e jetës, qoftë në raport me fqinjët e vet. Mundësia reale financiare e institucioneve qendrore dhe lokale, buxhetit dhe shoqërisë kosovare, janë shumë të kufizuara, ndërsa nevojat janë të mëdha dhe kërkesat vijnë nga të gjitha komunitetet dhe nga të gjitha kategoritë.

Poashtu është e ditur se numri i donatorëve, ku hyjnë fonde dhe organizata ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë dhe në komunën e Klinës, është zvogëluar, prandaj edhe mundësia e përkrahjes për projektet e komunitetit është më e vogël tash.

Një tjetër vështirësi është nga vet komuniteti, mënyra e tij e organizimit, ndërhyrja e politikës dhe mungesa e dëshirës për të marrë pjesë në jetën politike dhe shoqërore të komunës. Me mungesën e përfaqësimit në pushtetin lokal komuniteti shpesh lidhjet me komunën, institucionet dhe donatorët dhe kjo ndikon në zbatimin e kësaj strategjie në të cilën parashihet bashkëpunimi i të gjithë faktorëve. Probleme mund të ketë për faktin e gjendjes ekonomike e sociale të komunitetit, mungesa e zhvillimit, përçarja nga ndikimi i politikës dhe mungesa e elitës kulturore që do i printe komunitetit për të identifikuar nevojat e tij dhe rrugët e zgjedhjes. Komuniteti nuk është i organizuar sa duhet, nuk ka konkurrencë e garë mendimesh, projektsh politike e idesh. Sektori i shoqërisë civile

ndonëse është prezent nuk është formuluar ende.

Vështirësi në këtë aspekt paraqet fakti se pjesëtarët e komunitetit janë shpërndarë nëpër lokalitete të ndryshme që shumë herë janë larg nga njëri tjetri, në bashkësi të vogla që shumë herë nuk e kalojnë numrin e disa familjeve në një fshat. Në këtë mënyrë komunikimi dhe ndërveprimi brenda komunitetit është i paktë dhe mundësia e organizimit të përbashkët është e vogël. Në këto familje kryesisht jetojnë të moshuar dhe pak të rinj.

Sa i përket projekteve për punësim vështirësitë shtohen nga fakti se në Kosovë dhe komunën e Klinës papunësia është shumë e madhe, numri i vendeve të punës që mund të hapen është shumë i vogël dhe kjo bën të vështirë përfshirjen e pjesëtarëve të këtij komuniteti në projektet për punësim.

Vështirësia e fundit që duhet përmendur është për faktin se Strategjia është joobligative në kuptimin që nuk ka ndonjë organ përgjegjës i cili do zbatonte këtë dokument. Në këtë aspekt institucionet dhe donatorët vendosin vet për mënyrës se sa dhe si do të plotësojnë rekomandimet që dalin nga ky dokument. "Syri i Vizionit" inkurajon institucionet që të shfrytëzojnë sa më shumë këtë dokument dhe të plotësojnë aq sa munden nga kërkesat që dalin nga ky dokument.



II. Iniciativat dhe rekomandimet

2.1 Hyrje

Strategjia i qaset komunitetit në dy mënyrë: me qasjen në përgjithësi dhe sipas lokaliteteve të veçanta. Qasja e parë ka të bëjë me kërkesat dhe problematikat që kanë të bëjnë me komunitetin në përgjithësi kudo që jeton brenda komunës së Klinës. Në këtë pjesë bëhet fjalë për tematika të tilla që s'lidhen me lokalitetin por janë nevoja të përbashkëta për të gjithë komunitetin. Aty hyjnë kërkesat për përdorimin e gjuhës serbe, informimin, përfaqësimin politik, procesin e kthimit dhe integritit, etj. nga të cilat përfiton gjithë komuniteti në secilin lokalitet, përfshirë edhe lokalitetet më vogla në të cilat ka vetëm disa familje.

Strategjia është e mbështetur në debatet me komunitetin orientuar në shtatë fushat kryesore të konsideruara si më të rëndësishme për komunitetin. Ato janë:

1. Çështjet pronësore, të banimit dhe vendbanimet joformale
2. Edukimi dhe rinia
3. Punësimi dhe zhvillimi ekonomik
4. Shëndetësia dhe çështjet sociale
5. Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi
6. Kultura, mediat dhe informimi
7. Të drejtat e femrave

Në të vërtetë në shumë raste, problematikat me të cilat përballet komuniteti serb janë të përgjithshme, për të gjitha komunitetet. Me të njëjtën problematikë në shumicën e rasteve përballet edhe vet komuniteti shumicë shqiptar, siç janë çështjet e punësimit, zhvillimit ekonomik, bujqësisë, shërbimet joaq të mira shëndetësore, çështjet e ndihmës sociale, etj.

Por ka edhe problematika që janë të veçanta për komunitetin serb sikurse çështjet e lëvizjes, pjesëmarrjes dhe përfaqësimit politik, çështjet e ndërmarrësisë ekonomike në kuptimin e tregut, kultura e informimi, të drejtat e banimit dhe shfrytëzimit të pronës, etj.

Bazuar në takimet me komunitetin dhe nevojat që kanë paraqitur vet përfaqësuesit e komunitetit disa sektorëve u është dhënë më pak vëmendje në këtë strategji, duke u përqendruar në sektorë tjerë ku është menduar se kontributi mund të jetë më i madh për vet komunitetet.

2.2 Çështjet pronësore të banimit dhe vendbanimet joformale

Përshkrimi i gjendjes: Pjesa dërmuese e komunitetit serb të Komunës së Klinës jeton në zonat rurale. Përqendrimi tanishëm i kësaj popullate varet nga struktura etnike në këtë ambient si dhe ecuria e procesit të kthimit gjatë këtyre njëmbëdhjetë viteve të fundit. Koncentrimi i popullatës së këtij komuniteti është më i madh në fshatin Videjë dhe në vet qytetin e Klinës, ndërsa është edhe një numër i konsiderueshëm në fshatrat Dersnik dhe Bërkovë në krahasim me lokacionet tjera. Kthimi i komunitetit serb të kësaj komune ka filluar në vitin 2001 nga fshati Binçë ku në atë kohë ishin të vendosur individët e kthyer jo vetëm nga ky fshat por edhe nga lokacione tjera si qyteti i Klinës, fshatrat Grapc, Videjë etj. Në komunën e Klinës nuk ka pasur lokacione ku të mos jetë zhvendosur ky komunitet, sikurse është fjala për Gorazhdevcin e Pejës ose Crkolezin e Istogut, ku ka qëndruar popullata gjatë luftës po edhe pas saj pa ndërprerë e edhe tani është. Gjitha fshatrat e Klinës ishin të djegura gjatë luftës, ashtu që pas kthimit është dashur që të rindërtohen dhe riparohen shtëpitë dhe banesat e banorëve, që vlen edhe për komunitetin serb. Deri tani për këtë komunitet janë ndërtuar 56 shtëpi në Videjë, 45 shtëpi janë në Binçë, 40 shtëpi janë ndërtuar në Dersnik, ndërsa në Bërkovë janë 34 shtëpi, 28 shtëpi ka në Grapc, në Dollc janë 12 shtëpi, 10 shtëpi të ndërtuara në fshatin Rudicë, në Klinavc 13 shtëpi, në Pogradje poashtu 13 shtëpi, ndërsa në Gremnik deri tani janë ndërtuar vetëm 4 shtëpi.

Për të njëjtin komunitet në brendësi të qytetit të Klinës janë rindërtuar 117 shtëpi dhe banesa të riparuar që do të thotë më shumë se në çdo qytet të Regjionit të Pejës, të cilit i takon edhe Klina. Një përqindje e konsiderueshme të këtyre shtëpive të ndërtuara nuk shfrytëzohen, si dhe një numër jo i vogël i tyre tanimë janë shitur, edhe pse ato ishin ndërtuar që të stimulojnë procesin e kthimit të këtij komuniteti në Kosovë, gjegjësisht në vendlindjen e tyre. Ka raste

edhe të shitblerjeve jo legale, që është një nga brengat kryesore të këtij komuniteti dhe njëkohësisht edhe institucioneve publike. Procesi i kthimit tanimë vazhdon në mënyrë spontane sepse forma e organizuar është tejkaluar sepse tani ky komunitet jeton lirshëm dhe në të njëjtat kushte sikur komunitetet tjera duke e përfshirë edhe komunitetin shumicë.

Nuk ka ndonjë statistikë ose studim të pronësisë së objekteve të banimit të këtij komuniteti në vet qytetin e Klinës ndërsa shihet që numri më i madh i pronave të kthyera dhe të rindërtuara është në vetë qytet. Sipas AKP-së, të dhënat e muajit shtator të vitit 2010 për objekte banimi, në këtë institucion janë paraqitur pronarët e 5655 pronave (një pjesë e madhe e të cilëve janë serbë), ndërsa deri tani janë zgjidhur 394 raste të tilla ose 4,5 %. Poashtu ka raste të paraqitura dhe të nxitura nga AKP-ja, e nën administrim deri tani janë vënë në Klinë rreth 84 prona. Poashtu një numër i madh është lëshuar me qira e që është bërë përmes këtij agjencioni. Në këtë komunë pronat e rindërtuara të serbëve në pjesën urbane të qytetit kryesisht janë të fokusuar në dy lagje; një në Qendër dhe tjetra në Mëhallën e Epërme. Gjithashtu janë edhe në gjitha pjesët e tjera të qytetit edhe pse nuk janë kthyer të gjithë. Ka raste të shfrytëzimit të pronës siç janë banesat, shtëpitë, objektet ndihmëse dhe lokalet afariste që akoma bëhet pa leje të pronarit legjitim.

Sipas vërejtjeve të pronarëve, po ashtu ka edhe prona të uzurpuara që dëmtohen nga pakujdesia e shfrytëzuesit të ri ndërsa pronari i vërtetë akoma nuk është në mundësi që tërësisht të disponojë me pronën e vet. Agjencioni Kosovar i Pronës punon në menaxhimin e tyre dhe për momentin ai është i vetmi trup përgjegjës për çështjet pronësore të natyrës së banimit në Kosovë edhe pse kapaciteti me të cilin disponon ky agjencion është tejet i vogël për të menaxhuar me gjithë potencialin ekzistues të banesave të kontestuara në forma të ndryshme.

Në krahasim me zonat urbane, në fshatra çështja e pronësisë së shtëpive dhe pronësisë tjetër paraqet një problem më të vogël pasi që pronësia është më e përcaktuar. Problem të madh paraqet edhe uzurpimi i tokave bujqësore për shfrytëzimin e të cilave nuk kompensohet pronari i vërtetë nga fqinjët e tyre ose kompanitë e biznesit. Problemet më të shpeshta për pronarët dhe policinë janë më së shpeshti dëmet që bëhen në pyjet private të këtij komuniteti.

Sa i përket statusit të lokaliteteve të banuara me komunitetin serb në komunën e Klinës,

zonat që janë përfshirë në këtë strategji paraqesin zona formale dhe problemi i vendbanimeve joformale nuk është problemi që shfaqet në këtë moment të ky komunitet.

Pajisja e qytetareve me dokumentet kosovare për një kohë të gjatë në fillim të procesit të kthimit paraqiste problem, por kohëve të fundit ka një numër të madh të të interesuarve që po pajisen me këto dokumente.

Iniciativat ekzistuese:

Sa i përket rindërtimit të shtëpive dhe objekteve në favor të komunitetit, shumë donatorë të ndryshëm kanë marrë pjesë në zgjidhjen e kësaj problematike. Pas luftës në këtë komunë janë ndërtuar mbi 350 shtëpi. Organizatat dhe institucionet që kanë punuar në rindërtimin e shtëpive janë THW, DRC, UNDP-Spark, ICMC, Mercy Corps, Qeveria e Kosovës, Care Internacional, Qeveria e Serbisë, etj. që kanë mundësuar të sigurohet hapësira e banimit për një pjesë të konsiderueshme të këtij komuniteti.

Momentalisht (fundi i vitit 2010) po punohen diku rreth 13 shtëpi për komunitetin e kthyer si dhe 2 për komunitetin pritës si balanc program në këtë komunë, nga Ministria e Kthimit të Republikës së Kosovës, UNDP-Spark, Komuna e Klinës, DRC, etj: nga një shtëpie do të ndërtohet në Dollc, Bërkove, Dersnik dhe 3 në Videjë, poashtu do të ndërtohen edhe shtëpitë e para në fshatin Petriq i Poshtëm, ku bëhet fjalë për 4 shtëpi si dhe 3 shtëpi në Krushevë të Madhe, ku janë donatorë Ministria e Kthimit e Republikës së Kosovës, DRC-ja, Komuna e Klinës, etj. Në shtator të vitit 2010 janë kthyer 8 veta në fshatin Dugonjevë, të cilët përfshihen në listën që po përpilohet ku do të janë të përfshirë edhe 22 veta të programit RRK2 në lokacionet e ndryshme.

Agjencioni Kosovar i Pronës (AKP) merret me çështjet pronësore dhe zgjidh problemet e pronësisë në mandatin e vet për kërkesat që rrjedhin nga pasojat e luftës së vitit 1998/99 që ka të bëjë me pronën e patundshme private, që nënkupton pronën bujqësore dhe komerciale. AKP-ja bën pranimin dhe regjistrimin e kërkesave specifike për pronën e paluajtshme private, zbatimin e vendimeve përfundimtare ligjore dhe e bën administrimin e pronave të braktisura nga të zhvendosurit dhe refugjatët.

Rekomandimet për veprimet e mëtejme:

- Të forcohet KPA-ja dhe të jetë me aktive në mbrojtjen dhe menaxhimin e pronave
- Policia e Kosovës poashtu të ndihmojë realizimin e mandatit të AKP-së lidhur me pronat e serbeve
- Të kërkohen donatorë tjerë për të vazhduar rindërtimin e shtëpive
- Të shtohet kontrolli dhe mbrojtja e pyjeve në zonën e banuar nga komuniteti
- Të ketë nga komuna ndonjë formë të mbikëqyrjes për shit-blerjen e pronave në mënyrë që të mos ketë keqpërdorime dhe falsifikime që bëjnë të mundur që tokën ta shesin mashtruesit, që shkakton probleme më vonë
- Të përkrahet dhe të ndihmohet pajisja e qytetareve me dokumente legale të Kosovës

2.3 Edukimi dhe rinia

Përshkrimi i gjendjes: Në fshatin Videjë është shkolla fillore në gjuhën serbe që kontrollon nga institucionet paralele të përkrahura nga Qeveria e Serbisë. Aty e ndjekin mësimin nxënësit e fshatrave Videjë, Dersnik, Rudicë, Dollc, Klinë etj. Përveç kësaj shkolle deri në këtë vit ka ekzistuar edhe një shkollë fillore në fshatin Binçë për nxënësit e këtij fshati e poashtu edhe për fshatin fqinj Grapc, ku kishte një numër tejet të vogël të nxënësve, por megjithatë ka funksionuar deri më tani. Ndërsa sa i përket shkollimit të mesëm, nxënësit e kësaj komune udhëtojnë kryesisht në Mitrovicë, por edhe në Osojan të komunës së Istogut si shkolla më e afërme për komunitetin serb të komunës së Klinës ku vijojnë mësimin sipas planprogrameve të Republikës së Serbisë.

Në shumicën e fshatrave dhe në vet qytetin e Klinës ka një numër fare të vogël të të rinjve serb që jetojnë aty. Për këtë arsye në këto lokalitete nuk ka mjaft nxënës deri në fazën tjetër kur planifikohet dhe dëshirohet një kthim më i madh dhe më i qëndrueshëm, prandaj çështja e arsimimit për momentin nuk

paraqitet si çështje më prioritare e këtij komuniteti.

Në fshatrat e tjerë dhe në qytetin e Klinës momentalisht nuk ka nxënës nga komuniteti serb por pritet në të ardhmen e afërt nëse procesi i kthimit vazhdon të zhvillohet me sukses si deri tani, sepse mund të pritet të kthehen edhe më shumë të rinj e që mund të ndodh në Komunën e Klinës në një të ardhme të afërt.

Sa i përket arsimit parashkollor tek nxënësit e komunitetit serb në fshatin Videjë nuk ka ndonjë klasë parashkollore. Shkollën fillore të këtij fshati janë duke e vijuar 14 nxënës. Në fshatin Binçë ishin 3 nxënës vitin e kaluar shkollore, por ky objekt shkollor është mbyllur këtë vit për shkak të numrit të vogël të nxënësve. Ndërsa në shkollën e mesme në Mitrovicë shkojnë 7 nxënës, e në shkollë të Osojanit që gjendet afër në komunën fqinje të Istogut, nga kjo komunë këtë vit akademik shkon vetëm një nxënës i komunitetit serb të Klinës.

Sa i përket arsimit të lartë, studentët nga ky komunitet ndjekin studimet në Universitetin e Mitrovicës, që poashtu punon me planprogramet e Republikës së Serbisë, ose nëpër universitetet tjera në brendësi të Serbisë. Për momentin është vetëm një student që nga kjo komunë udhëton për të studiuar në pjesën veriore të Mitrovicës. Fakulteti i Shkencave Aplikuara të Biznesit në Pejë ka disa drejtime edhe në gjuhën boshnjake, por në ato deri më tani nuk ka asnjë student serb edhe pse ka mjaft vende edhe për ta.

Autorët e kësaj strategjie mendojnë se në një të ardhme sa më të shpejtë, shkollat multietnike duhet të jenë synim i shoqërisë dhe institucioneve arsimore në këtë komunë. Gjendja e të rinjve në këtë komunitet varet nga kushtet e rrethanat që ka jetuar komuniteti gjatë dhjetë vjetëve të kaluara. Përveç fshatrave, Videjë, Bërkovë, Dersnik, Binçë e Grapc ka pak ose aspak të rinj, pasi që ata nuk gjejnë perspektive në Kosovë dhe ose largohen në Serbi a në vendet perëndimore. Jeta politike dhe shoqërore që zhvillohet brenda komunitetit serb është e tillë që nuk ofron mjaft mundësi për kyçje të të rinjve. Ata janë pak të kyçur në politikë, ndërsa subjektet politike që veprojnë brenda komunitetit nuk kanë degët e forumeve rinore brenda partive. Në fshatin Videjë ka një qendër të komunitetit me lidhjet e internetit, fusha sportive dhe kushtet tjera për rininë. Një nga hapësirat sportive është edhe terreni për futboll të vogël në fshatin Videjë, i cili ka dale si iniciativë sivjetshme e përkrahur me mini grante nga vet

projekti i realizuar nga Syri i Vizionit dhe Olaf Palme Center. Në fshatrat Videjë dhe Bërkovë ka organizime të grupeve joformale rinore, por akoma jo edhe ndonjë organizatë joqeveritare të regjistruar ku mund të fillonin iniciativa dhe aktivitetet e tyre.

Iniciativat ekzistuese:

Ekzistuese dy shkolla të vendosura në ambiente private që janë adaptuar për ofrimin e mësimin të nxënësve në dy lokalitete të ndryshme: Videjë dhe Binçë, por që të dy këto hapësirat/objektet private nuk i plotësojnë kushtet elementare për këtë dedikim. Ka edhe një shkollë të kompletuar në fshatin Dollc por ajo s'përdoret në mungesë të nxënësve.

Qeveria e Serbisë përveç pagesave për personelin arsimor bën edhe pagesën e transportit për nxënësit nga fshatrat fqinje. Stafi arsimor përfiton edhe me benefite të ndryshme nga sistemi paralel të krijuar nga pushteti i Serbisë që akoma ilegalisht funksionon në Kosovë.

Në fshatin Videjë ekziston një qendër rinore që është ndërtuar dhe e pajisur nga USAID, Mercy Corps dhe Komuna e Klinës, etj, në të cilën mund të zhvillohen aktivitete të ndryshme rinore. Aty ka lidhje të internetit e mundësi tjera të ndryshme.

Nga organizata të ndryshme deri më tani janë mbajtur edhe aktivitete dhe turnire futbollit dhe aktivitete tjera të përbashkëta.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- Të krijohen kushtet për shkollat multietnike
- Të adaptohen objektet shkollore për pranimin e arsimit edhe në gjuhën serbe
- Të inkurajohen të rinjtë e komunitetit të kthyer për marrjen e përgjegjësive politike
- Të angazhohen në aktivitete kulturore dhe sportive
- Të kyçen në projektet e përkrahjes dhe fuqizimit të të rinjve
- Të ketë me shumë aktivitete sportive, kulturore etj të nxitura nga vet të rinjtë si psh. turnire futbollit, ekspozita artistike, mbrëmje rinore, e tjera.

2.4 Punësimi dhe zhvillimi ekonomik

Përshkrimi i gjendjes: Serbët që jetojnë momentalisht në komunën e Klinës e përbejnë një komunitet të vogël në kuadër të popullsisë së përgjithshme të komunës. Sipas të dhënave që i posedon Komuna e Klinës banor të regjistruar në këtë komunë me përkatësi komunitetit serb janë diku mbi 1200 individë të regjistruar (shumica e tyre nuk qëndron rregullisht këtu) në një komunë ku janë rreth 65 mijë banorë, ku ky komunitet në të kaluarën përbënte një bashkësi me disa mijëra banorë. Numri i atyre që punojnë nuk është i vogël nëse krahasohet me komunitetin shumicë, por edhe me të gjithë rajonin që përballet me problematikën e papunësisë së madhe dhe ku një pjesë e mirë e popullatës jeton në kushte të vështira dhe varfëri. Ata marrin paga nga Qeveria e Serbisë, kurse një numër i vogël i pjesëtarëve të këtij komuniteti momentalisht marrin paga nga buxheti i Qeverisë së Kosovës. “Syri i Vizionit” ka mbledhur të dhënat nga terreni dhe ato paraqesin gjendjen e cila tregon se në marrëdhënie të punës janë mbi 80 persona të komunitetit serb që paguhen nga Qeveria e Serbisë për komunën e Klinës (26 janë në administratë, 23 në arsim, 5 në shëndetësi, në postë 3 etj). Të punësuar në institucionet e Kosovës momentalisht janë vetëm dy persona (të dy në administratë). Të ardhura që marrin ata ndikojnë në përmirësimin e gjendjes ekonomike të komunitetit pa marrë parasysh se nga vijnë.

Sektori i arsimit dhe shëndetësisë një kohë merrte paga edhe nga Qeveria e Kosovës për punëtorët e vet, por këto tre vitet e fundit Qeveria e Serbisë i ka kushtëzuar qytetarët serbë që të mos pranojnë këto pagesa. Poashtu në këtë komunitet ka edhe ndonjë ndërmarrës privat të biznesit, por biznesi i tyre kryesisht kufizohet brenda lokalitetit dhe komunitetit të vet deri tani.

Pjesa dërmuese e këtij komuniteti në të kaluarën, para luftës, ka qenë pothuajse tërësisht e punësuar në sektorin shtetëror dhe janë mbajtur nga pagat aty, kurse të ardhurat shtesë kanë marrë nga tokat e tyre që kryesisht shtrihen në zonat më të mira pjellore dhe me sistem të ujitjes së mirë. Por në periudhën në vazhdim orientimi i tyre duhet të bëhen të bujqësia dhe blegtoria. Në vitet e kaluara ka pasur disa projekte për të ndihmuar e posaçërisht në zhvillimin e blegtorisë dhe bujqësisë, ndihma të ndryshme me mjete teknike të punës dhe me fondin e bagëtive. Nga kjo ndihmë është ndihmuar vet komuniteti, me gjithë rastet e përfitimt personal. Për menaxhimin efikas me këto të mira materiale të përbashkëta që është

dhuruar nga donatorët e ndryshëm është dashur që të krijohen kooperativat bujqësore formale por edhe jo-formale që bëjnë bashkimin e mjeteve dhe për t'i evituar keqpërdorimet që në disa raste kanë ndodhur si dhe të jepet një shtytje efektive zhvillimit ekonomik.

Në këtë komunë ka këto kooperativa bujqësore:

- 1) Shoqata “Brazda-V” në Videjë
- 2) Kooperativa bujqësore “Prva Brazda”, Berkovë
- 3) Asociacioni i bujqve “Klas”, Binçë
- 4) Kooperativa “Grabac” në Grapc
- 5) Kooperativa bujqësore ARUD në Dërsnik
- 6) Kooperativa bujqësore “Rudice” në Rudicë

Iniciativat ekzistuese:

Numri i madh i këtyre është i punësuar, së paku 80 marrin paga por edhe kompensime tjera duke i siguruar mjetet materiale për familjarët e tyre që e ngrit nivelin e gjendjes ekonomike të komunitetit në fjalë.

Policia e Kosovës dhe Forca Mbrojtëse e Kosovës vazhdimisht kanë paraqitur ftesën për pjesëtarët e këtij komuniteti që të punësohen në këto institucione. Mendohet që në një të ardhme shumë të afërt do të ketë pjesëtarë të këtij komuniteti nëpër shërbimet publike, që për momentin refuzimet nga vet komuniteti janë të forta.

Organizata dhe institucione të ndryshme kanë ndihmuar banorët e fshatrave për bujqësi. Në fshatin Videjë janë dhuruar disa traktorë dhe nja lope ëpr secilën familje nga RTM italiane, AED-i, USAID-i, Qeveria e Serbisë etj, por kanë përfituar edhe projekte në infrastrukturë. IOM ka dhuruar nga 4 mijë euro për dy familje. Përveç shtëpive DRC-ja për shembull ka ndërtuar ujësjellësin dhe ka bërë rekonstruimin e rrjetit elektrik të Videjës, Mercy Corps-i ka asfaltuar një rrugë në gjatësi 700 metra, Komuna e Klinës me USAID-in dhe Mercy Corps e kanë ndërtuar dhe pajisur një qendër rinore etj. Ekziston pika e grumbullimit të qumështit ndërtuar nga DRC, kuzhina popullore si dhe iniciativa private e theksuar siç janë lokalet tregtare, shërbyese, prodhuese, blegtoria etj. Po në fshatin Videjë ka një shkollë fillore dhe funksionon telefonia fikse dhe shërbime tjera.

Pjesëtarëve të këtij komuniteti që jetojnë në brendësi të qytetit të Klinës, Zyra Lokale për komunitete u ka ndihmuar në furnizim me mobile, kurse Qendra Koordinuese nga Mitrovica iu ka shpërndarë elektro pajisje shtëpiake, së paku nga një artikull më të nevojshëm për çdo amvisëri. DRC-ja ka dhuruar krevate për 30 familje si dhe ka ndihmuar me pajisje pune siç janë; aparatet për saldim, motokultivatorët, pajisje të

zdrukthëtarisë, makina për prodhim të gozhdëve, e tjera të ndryshme. Manastiri i Deçanit ka dhuruar traktor me mekanizimin tjetër të nevojshëm për bujqësi, poshtu pajisje elektroshtëpiake si dhe një kombibus. Unija-M poashtu ka falur një traktor, ndërsa IOM-i ka dhuruar pajisje të nevojshme për një punëtor për automekanik.

Në Dersnik janë ndihmuar me dru për ngrohje dhe pajisje elektroshtëpiake nga DRC-ja. Manastiri i Deçanit u ka dhuruar një traktor me pajisje, poashtu edhe nga Qendra Koordinuese kanë përfitur me një traktor me pajisje komplete. Po nga Qendra Koordinuese kanë marrë 30 pako me vegla të punës në bujqësi, si dhe teknike elektroshtëpiake për 22 familje. Gjithashtu nga UNDP-ICMC kanë marrë pajisje në vlerë deri në 700 Å për familje. UNHCR-i dhe AED-i i kanë ndihmuar përmes OJQ-së "ARUD" me nga një traktor dhe motokultivator. Në fshatin Berkovë kanë përfitur nga Mercy Corps dhe USAID nga një traktor ndërsa komuna ka shtuar pajisjet tjera ndihmëse. UNDP për 34 familje ka dhënë grante për pajisje në vlerë deri 2.000 Å për çdo amvisëri. Manastiri i Deçanit ka dhënë një minibus, ndërsa KFOR-i sloven ka ndihmuar me ndërtimin stallave bujqësore dhe një garazhi si ka ndërtuar një rrugë në gjatësi 500 m si dhe një urë që i lidh me fshatin Rudicë, po ashtu edhe UNDP u ka ndërtuar një rrugë të gjatësisë 2 kilometra.

Në fshatin Rudicë organizata Mercy Corps ka dhënë donacionin në makineri për mbjellje dhe nxjerrje të patateve, dhe të gjitha pajisjet e traktorëve për kositje, dhe funksione tjera. Edhe UNDP ka ndihmuar me një traktor. Ndërsa në fshatin Grapc IOM-i ka ndihmuar në hapjen e një dyqani si dhe ka dhuruar një makinë cirkular me shumë operacione. AKTED-i ka ndihmuar gjysmën e fshatit me lopë, pula, derra etj. Manastiri i Deçanit poashtu i ka përkrahur me një traktor me pajisje, kurse USIAD me traktorë dhe pajisje bujqësore. Fshati Binçë nga Komuna e Klinës ka përfitur me një traktor me të gjitha pajisjet e nevojshme për punët e ndryshme. Edhe AKTED-i ka dhuruar një traktor me rimorkio, makinë korrëse dhe pajisje shtesë për punë bujqësore. IOM-i ka dhuruar lopë, dele, pula, etj. Mercy Corps-i ka asfaltuar një rrugë të gjatësisë prej 3 kilometra, kurse KFOR-i italian e ka bërë ujësjellësin e fshatit. Nga Mercy Corps-i është përfitur edhe një makinë për prodhim të koncentratit, një mulli guri, një traktor me rimorkio dhe mjetet tjera shtesë. Fshatit Dollc DRC-ja i ka dhuruar nga 2000 euro secilës familjes për të filluar jetën në Kosovë. Poashtu ajo ka dhuruar makineri bujqësore për kositjen, mbledhjen dhe presimin e sanës, etj. dhe ka interesim që të

ndërtojë një mulli, i cili do të shërbejë tërë regjionit të Pejës me kapacitet të madh. Mercy Corps poashtu ka dhuruar pajisje bujqësore. OJQ Syri i Vizionit nga Peja ka dhuruar një prerëse të druve –cirkular për nevojat e fshatit.

Donatorë të ndryshëm, vendorë dhe ndërkombëtarë, kanë ndihmuar edhe në forma tjera të ndryshme. Pavarësisht se një pjesë e tyre kanë humbur, vjedhur ose keqpërdorur dhe mënyrës se si janë menaxhuar këto pajisje një pjesë e tyre janë përdorur në mënyrë të duhur dhe për gjithë komunitetin, pavarësisht nëse fermerët i kanë mbajtur apo jo bagëtinë e dhuruar apo janë shitur menjëherë, kjo përkrahje ka krijuar një potencial për zhvillimin e bujqësisë në këtë komunitet. Zhvillimin e këtij komuniteti duhet parë edhe në dhjetëra projekte të ndryshme të zhvilluara nga vet Komuna e Klinës, ku hyjnë çështjet e ndryshme si psh. rregullimi i rrugëve të ndryshme, ndërtimi i ujësjellësit, riparimet e rrjetit energjetik, riparimet e objekteve të shkollave, qendrave rinore dhe të kulturës, etj. që kanë ngritur mirëqenien e qytetarëve.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- Punësimi në institucionet legale i një numri më të madh të pjesëtarëve të komunitetit serb
- Inkurajimi i të rinjve për iniciativa të ndryshme rinore së bashku me komunitetet tjera dhe institucionet
- Angazhimi më i madh i pjesëtarëve të këtij komuniteti në projektet që kanë të bëjnë me interesat e vet komunitetit në fjalë
- Punësimi i serbëve në ruajtjen e pyllit, pasi që është një sektor ku po shkaktohen shuam dëme nga keqbërësit
- Ofrimi i ndihmës për krijimin e fermave, mini-bizneseve dhe iniciativave tjera duke ofruar përkrahje dhe duke gjetur donatorë potencialë, etj.
- Të nxiten iniciativat e krijimit të kooperativave dhe bashkëpunimi mes fermerëve të këtij komuniteti me ata të komunitetit shumicë
- Ngritja e vetëdijes për rëndësi dhe informimi më i mirë tek fermerët lidhur me mundësitë e avancimit në sektorët e bujqësisë, blegtorisë si dhe sferave tjera.

2.5 Shëndetësia dhe çështjet sociale

Përshkrimi i gjendjes: Pjesëtarët e komunitetit serb kanë shërbime shëndetësore në ambulancat e afërta në fshatrat ku jetojnë, kurse ata që jetojnë në zonën urbane kanë shërbime të përbashkëta me popullatën shumicë. Kujdesi ndaj shëndetit kryesisht realizohet në ambulancën e fshatit Osojan në komunën fqinje, kurse për raste tjera të shërbimeve nga shëndetësia sekondare, ata shërbimet i marrin në Spitalin e Pejës dhe të Mitrovicës.

Sa i përket shërbimeve sociale duhet pasur parasysh se shoqëria kosovare nuk ofron shumë në politikën sociale. Numri i vogël i atyre që përfitojnë këtë ndihmë vjen për shkakun se kriteret për të përfituar janë shumë të vështira dhe të paktë janë ata që mund t'i plotësojnë. Në periudhën e këtyre tre viteve të fundit edhe shteti i Serbisë ka shtuar kriteret ashtu që shumë përfitues kanë humbur mundësitë e përfitimit nga ky burim.

Në muajin nëntor të vitit 2010 Qendra për Pune Sociale e Klinës mes përfituesve të këtij beneficioni ka një numër shumë të vogël familjesh të komunitetit serb. Poashtu edhe së paku 3 persona (disa janë në procedurë) që përfiton nga fondi pensional i Republikës së Kosovës në komunën e Klinës. Numri i përfituesve të këtyre beneficioneve nga Qeveria e Serbisë nuk dihet por sipas të dhënave zyrtare publike ato janë shumë më të mëdha nga këto të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Iniciativat ekzistuese:

Institucionet vendore dhe ndërkombëtare gjatë njëmbëdhjetë vjetëve të kaluara kanë realizuar dhjetëra projekte infrastrukture për përmirësimin e kushteve të jetës përfshirë rrugë, ujësjellës e kanalizime, etj. në të gjitha lokalitetet ku jeton komuniteti serb, që ka ndikuar në kualitetin e jetës në këto lokalitete. Në Klinë ka disa pika shëndetësore, të përbëra nga një infermiere të cilat financohen nga Qeveria e Serbisë për t'u kujdesur për këtë komunitet të shpërndarë nëpër pothuajse tërë territorin e komunës së Klinës dhe ata kryejnë shërbime primare. Ky staf mjekësor bën vizita nëpër fshatra për nevojat e komunitetit e kohë pas kohe angazhohen edhe specialistë të mjekësisë por jo mjaftueshëm.

Ndërkohë edhe autoritetet e shëndetësisë kosovare ofrojnë shërbime mjekësore bashkëkohore dhe të kompletuara pa dallim për të gjitha komunitetet nëpër ambulancat dhe në qendrën spitalore në Klinë.

Përveç përfituesve nga ndihma sociale ka iniciativa të ndryshme të vetdijesimit që të informohen të kthyerit rreth kriterëve dhe sa ma shpejt t'u mundësohet që t'i realizojnë këto të drejta. Ata po ashtu marrin edhe paga nga shteti fqinj serb por nuk dihen të ardhurat e sakta dhe vet numri i këtyre përfituesve. Shërbimi nga punonjësit e shërbimit shëndetësor të angazhuar nga pushteti serb është falas për dallim nga institucionet e menaxhuara nga institucionet kosovare në të cilat pacientet participojnë me njëfarë pagese.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- Të bëhet vetëdijesimi i komunitetit lidhur me përparësitë dhe posedimin e shërbimeve në qendrat mjekësore të Kosovës
- Të shtohen vizitat mjekësore në lokalitete ku jeton ky komunitet
- Të përkrahen projektet e OJQ-ve të këtij komuniteti që kanë të bëjnë me kujdesin ndaj shëndetit
- Të punësohet një numër i stafit mjekësor në qendrat spitalore nga komuniteti serb
- Të përkrahen kategoritë e njerëzve me nevojë, e posaçërisht njerëzit e moshuar që jetojnë pa përkujdesje familjare
- Të ngritet niveli i menaxhimit dhe bartjes së mbeturinave nga këto fshatrat

2.6 Siguria, të drejtat e minoriteteve dhe përfaqësimi

Përshkrimi i gjendjes: Më se njëmbëdhjetë vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, komuniteti serb në komunën e Klinës jeton kryesisht në ato lokalitete ku paraqitet një shumicë ose një numër më i madh. Kthimi është realizuar kryesisht në fshatra, dhjetëra fshatra janë përfshirë, ku është kthyer një numër shumë i vogël banorësh, kurse në zonën urbane të Klinës ka një numër të kthyerve që poashtu nuk është i vogël. Kthimi i parë në këtë komunë është realizuar në fshatin Binç në vitin 2001 ku të kthyerit e parë ishin nga fshatrat e ndryshme rreth këtij fshati dhe nga vet qyteti i Klinës. Në vitet e para pas lufte ka pasur disa incidente, por me përjashtim të ngjarjeve të vitit 2004 kur u bënë shkatërrime në gjithë Kosovë, nuk ka pasur probleme të mëdha dhe kthimi është realizuar në nëntë fshatra, ku prej më shumë se një

viti KFOR-i nuk i merret me sigurinë që tregon një përmirësim të gjendjes.

Pjesëtarët e komunitetit serb tashmë lëvizin të lirë, dalin për punë administrative dhe shitblerje në Klinë të pashoqëruar edhe pse ka pasur ndonjë herë incidente të vogla lidhur me pronësitë. As në hyrje të fshatrave ka disa vjet që janë larguar postbllloqet. Kjo atmosferë me e mirë dhe angazhimi i madh i autoriteteve komunale të Klinës dhe Qeverisë së Kosovës, kanë bërë që në vjetët e fundit të kemi edhe shtim të numrit të të kthyerve në qytetin e Klinës, që janë mirëpritur nga fqinjët e tyre, diçka që para disa vjetësh duke e pamundur.

Por derisa në aspektin e kthimit, sigurisë dhe lirisë së lëvizjes së lirë janë bërë përparime të mëdha në këto pesë vjetët e fundit, në aspektin e përfaqësimit politik ka pasur ngecje në tre vjetët e fundit. Pushteti serb i ka kushtëzuar serbët që të refuzojnë përfshirjen në institucionet legale të Kosovës si psh në arsim, shëndetësi, polici, administratë komunale, përfaqësi politike e pozita tjera që garantojnë përparim më të shpejtë të këtij komuniteti.

Serbët e Klinës nuk kanë asnjë përfaqësues në Kuvendin Komunal të Klinës. Në dy mandatet e para të Kuvendit Komunal nga viti 2001-2004 në kuvendin ka pasur nga një përfaqësues të serbëve. Në dy palë zgjidhje lokale, subjektet politike serbe nuk kanë marrë pjesë, por përfaqësuesit e tyre kanë qenë të emëruar nga përfaqësuesi i UNMIK-ut në marrëveshje me autoritetet komunale dhe me komunitetin.

Në dy zgjedhjet e fundit komunale subjektet politike serbe nuk kanë marrë pjesë në votimet komunale, dhe ata kanë mbetur pa përfaqësues në Kuvend. Llogaritet se kapacitetet votuese të tyre janë për të nxjerrë një ose dy deputetë komunalë. Angazhimi i autoriteteve komunale dhe kontakti me përfaqësuesit e komunitetit serb bashkë me përkrahjen nga autoritetet ndërkombëtare në Kosovë kanë krijuar një klimë shumë të mirë të komunikimit, që mund të shërbejë për të ndikuar tek komuniteti serb që të dalë në zgjedhjet a ardhshme.

Momentalisht në Komitetin për Komunitete të Kuvendit të Klinës janë dy pjesëtarë të komunitetit serb.

Sa i përket trajtimit të komunitetit serb në komunën e Klinës goftë në përfaqësim, në procesin e kthimit, integritetit dhe rindërtimit të shtëpive, gjithmonë autoritetet ndërkombëtare dhe pushteti lokal i Klinës kanë pasur parasysh se ky komunitet ka pasur një trajtim të veçantë krahasuar me komunitet tjera pakicë. Kjo ka ndodhur për shkak të procesit politik në Kosovë. Interesimi i faktorëve ndërkombëtar për komunitetin ka qenë i madh për shkak të luftës që ka ndodhur më parë dhe për shkak të garancive të vazhdueshme që është dashur të jepen për serbët në Kosovë, për sigurinë e tyre, kthimin, integritetin, etj. Favorizimi i këtij komuniteti është bërë në procesin e kthimit, rindërtimit të shtëpive e punësimit, në krahasim me komunitet boshnjake, egjiptase e rome që aktualisht kanë numër më të madh të banorëve por kanë përfaqësim shumë më të vogël. Sa i përket ndërtimit të shtëpive të djegura gjatë luftës, serbët e Klinës kanë përfituar rreth 350 shtëpi dhe është realizuar kthimi i organizuar në dhjetë lokalitete në

komunën e Klinës, kurse për komunitetin rom e egjiptian janë realizuar vetëm projektet e kthimit në fshatin Klinavc. Pos kësaj komuniteti serb ka një përkrahje të madhe nga Qeveria e Serbisë që ofron numër të madh pagash dhe të ardhurash tjera për këtë komunitet.

Iniciativat ekzistuese:

Gjuha serbe përdoret në shkollim, në shkollat e këtij komuniteti dhe mësohet me planprogramet e hartuara nga Ministria e Arsimit të Serbisë.

Gjuha serbe është edhe gjuhë zyrtare në komunë. Në këtë gjuhë përkthehen të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentacioni komunal. Në këtë gjuhë janë edhe të gjitha mbishkrimet në institucionet shtetërore, shkolla, rrugë, tabela komunikacioni dhe çkado që shkruhet në ambientet publike.

Komuna e Klinës ka punësuar dy pjesëtarë të këtij komuniteti në administratë dhe ka gatishmëri për të pranuar edhe të tjerë. Në arsimin e lartë të Kosovës ka një mundësi për regjistrimin e studentëve të këtij komuniteti në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit në Pejë ku zhvillohet mësimi në disa drejtime në gjuhën boshnjake.

Përfaqësimi i pakicave në parlamentin e Kosovës është i paraparë me Kushtetutën e Kosovës. Sipas kushtetutës në Parlamentin e Kosovës 100 vende deputeti fitohen me vota kurse 20 tjera janë të parapara për pakicat, nga të cilat 10 për serbët. Në Klinë një nënkryetar komune dhe një nënkryetar i Kuvendit komunal është i paraparë të jetë nga komunitetet pakicë. Momentalisht pasi që serbët nuk marrin pjesë në zgjedhje, këto vende janë të mbuluara.

Dy përfaqësues të serbëve merr pjesë në Komitetin për komunitete. Kuvendi ka dy komitete që janë të parapara për të trajtuar problemet e pakicave: Komitetin për komunitete dhe Komitetin për ndërmjetësim, në të cilat pakicat kanë shumicën e anëtarëve, kurse komuna ka Zyrën lokale për komunitete dhe Zyrën për kthim. Kuvendi komunal deri në vitin 2010, çdo vit ka ndare ka 11 përqind të të buxhetit të tij vjetor për komunitetet pakicë. Komuna çdo vit harton strategjinë e kthimit dhe e miraton atë në Kuvend Komunal.

Rekomandimet për veprime të mëtejme:

- Të punohet në integrimin e komunitetit serb
- Të punohet me komunitetin për të dalë në zgjedhjet e ardhshme kosovare
- Të analizohet mundësia që të ketë vende të rezervuara për serbët në Kuvendin Komunal
- Të nxiten projekte të përbashkëta multietnike që ndikojnë në kontakte ndërfaqinësore
- Të zhvillohen fushata vetëdijesimi rreth funksionimit të institucioneve vendore, ligjet dhe rregulloret lokale

2.7 Kultura, mediat dhe informimi

Përshkrimi i gjendjes: Komuniteti serb në komunën e Klinës ka kulturën e vet dhe gjuhën të ndryshme nga komuniteti shumicë shqiptar që jeton në komunë. Për këtë arsye në çështjet e kulturës dhe informimit, komuniteti ka kërkesat e veta të veçanta dhe ato lidhen me lidhjen e pashkëputur që ka ky komunitet me vendin e vet amë-Serbinë. Kështu sa i përket informimit pothuaj tërësisht informohen nga mediat e Serbisë me qendër në Beograd. Në fshatin Gorazhdec ekziston një radio lokale që jep edhe informata lokale për komunitetin në rajonin e Pejës, ku hyn dhe Klinë, dhe transmeton program 24 orësh. Radio Gorazhdec duke qenë pjesë e një rrjeti transmetues të radiove serbe në Kosovë, sjell edhe lajme të nevojshme nga komunat dhe lokalitetet tjera të komunitetit serb në Kosovë dhe deri diku ndikon në krijimin e një hapësire të përbashkët informimi dhe komunikimi mes vet komunitetit serb në Kosovë. Poashtu është edhe një radio tjetër e që gjendet në afërsi në komunën e Skenderajt, Radio Tri Srca dëgjohet edhe në komunën e Klinës. Po ashtu edhe Radio KFOR-i ka program informues edhe në gjuhën serbe, si dhe një revistë për të rinjtë.

Ndërsa sa i përket televizioneve, nëpër fshatra banorët janë të lidhur me kanale satelitore, që u sjell atyre programet e qindra televizioneve të Serbisë. Këto kanale ofrojnë programe të mjaftueshme informative, argëtuese e kulturore për komunitetin. Por komuniteti ka nevojë për më shumë lajme që kanë të bëjnë me jetën e serbëve në Kosovë dhe në komunën e Klinës, që janë të pakta në mediat qendrore të Serbisë. Komuniteti serb në Klinë nuk ka ndonjë medium të shkruar. Gazetat ditore dhe revistat një kohë të gjatë

vinin nga Serbia, por këto vjetët e fundit në fshatra nuk arrin më shtypi serb. Për shtypin kosovar nuk ka ndonjë interesim. Për pesë vjet një pjesë e nevojës së komunitetit është plotësuar edhe me gazetën rajonale të shoqërisë civile "Kasneci" (Glasnik), gazetë e cila me financimin e OSBE-së, USAID dhe donatorëve tjerë deri në vitin 2007 kur është ndërprerë, është botuar në dy gjuhë shqip dhe serbisht dhe ka informuar për jetën dhe problemet e serbëve në tërë rajonin e Pejës. Gazeta është udhëhequr fillimisht nga OSBE e pastaj nga OJQ "Syri i Vizionit" nga Peja dhe në kuadër të saj ka pasur disa faqe kushtuar komunitetit serb.

Sa i përket kulturës, në komunën e Klinës ka disa objekte me rëndësi të trashëgimisë kulturore, kryesisht kisha dhe objekte të kultit, njëra në Dersnik, kurse tjetra në Budicalc, etj.

Në kuadër të komunitetit momentalisht nuk ka asnjë shoqatë që do merrej me ruajtjen dhe vazhdimin e trashëgimisë kulturore folklorike serbe. Më parë për ruajtjen e trashëgimisë kulturore popullore ka ekzistuar një shoqëri kulturore artistike, e cila ka më se dhjetë vjet që nuk funksionon. Deri më tani komuniteti nuk ka parashtuar kërkesën e krijimit të ndonjë farë SHKA apo qendre të kulturës serbe, që do të mund të luante rolin e një koordinatori të jetës kulturore. Ky organ mund të motivonte të rinjtë që të mësojnë dhe të mbajnë më tej këtë trashëgimi në të cilën përfshihen këngët, vallet dhe veshjet tradicionale serbe. Krijimi i këtij organi do duhet të përkrahej edhe me faktin se duhen fonde duke filluar që nga veshjet tradicionale që janë shumë të shtrenjta, etj.

Në fshatrat Videjë, Berkovë dhe Dersnik ka infrastrukturë dhe hapësirë të nevojshme për këto aktivitete ku të rinjtë mund t'i bashkëngjiten e pastaj kur aftësohen të inicojnë ndërtimin e objekteve të nevojshme kulturore, edhe pse në fillim këtë rol mund ta luajnë edhe shtëpitë private të vogla që nuk janë të banuara për momentin. Objektet e përmendura do të ishin në shërbim qoftë për aktivitete kulturore, të rinisë, gruas dhe për nevojat tjera të komunitetit në fjalë.

Iniciativat ekzistuese:

Në televizionin publik të Kosovës RTK ka lajmet 15 minutash çdo ditë në gjuhën serbe, ndërsa në mbrëmje gjysmë ore përcjellë lajmet e Zërit të Amerikës në gjuhën serbe. Ky televizion poashtu ka një magazinë javore një orë në gjuhën serbe "Nedeljni kolaz". Këto emisione shërbejnë sadopak në informimin në gjuhën dhe kulturën serbe. Programi në gjuhën serbe poashtu jep edhe informata për jetën e komunitetit dhe zhvillimet që ndodhin në këtë komunitet, ngjarjet me rëndësi dhe zhvillimet duke krijuar një hapësirë lidhje mes serbëve të Kosovës.

Radio Gorazhdeci dhe Radio "Tri srca" janë radio në të cilat shumë organizata kanë dhënë donacione dhe janë zhvilluar shumë projekte në mënyrë që të ketë një radio lokale vërtetë në shërbim të komunitetit.

Gazeta "Kasneci" për pesë vjet ka sjellë zhvillimet nga komunat e rajonit në botimin në gjuhën serbe dhe ka sjellë për lexuesin shqiptar problemet që ka komuniteti serb në komunat Pejë, Klinë, Deçan e Istog.

Ka disa qendra rinore si dhe shtëpi kulture nëpër fshatra të cilat mund të aktivizohen me aktivitete në rast se komuniteti ka ide dhe interesohet për gjetjen e donatorëve me të cilin mund të realizohen këto synime të rinjve që deri tani janë pasiv.

Rekomandime për veprime të mëtejme:

- Të përkrahet krijimi i një SHKA-je (ose ndonjë organi tjetër kulturor) që do merrej me ruajtjen e trashëgimisë folklorike të komunitetit serb
- Të ndahet buxhet për ruajtjen e trashëgimisë së këtij komuniteti
- Të financohet ndërtimi i shtëpive të kulturës nëpër fshatra
- Të shikohet mundësia e hapjes së një gazete në gjuhën serbe ose të vazhdohet botimi i gazetës Kasneci/Glasnik
- Të promovohen programe për ruajtjen e trashëgimisë kulturore serbe në komunën e Klinës

2.8 Të drejtat e femrave

Përshkrimi i gjendjes: Sa i përket pozitës së femrës në komunitetin serb, nuk ka ndonjë dallim me komunitetet tjera në këtë komunë. Familjet e këtij komuniteti kryesisht janë familje patriarkale që funksionojnë në mënyrë të tillë që nuk i japin shumë hapësirë pjesëmarrjes së gruas në jetën politike e shoqërore të komunitetit. Subjektet politike të komunitetit serb nuk kanë organizatat e gruas në kuadër të partisë, ndërsa edhe interesimi i grave për politikën nuk është shumë i madh. Sa i përket punësimit dallimi mes mashkullit e femrës nuk është i madh në sektorin publik, porse në familjet e shumta të papuna gratë kryesisht merren më punët e shtëpisë dhe amvisëri. Në këto dhjetë vjet ka pasur përpjekje për të krijuar një sektor joqeveritar të organizimit të grave por ende nuk janë arritur rezultate me gjithë disa nisma që nuk kanë shumë jetëgjatësi. Në qytetin e Klinës si dhe në fshatrat Videjë, Bërkovë dhe Dersnik ka një numër të konsiderueshëm të komunitetit të kthyer ku një numër të respektueshëm e bëjnë edhe gratë. Në gjitha fshatrat ka një numër të grave ndërsa në fshatrat e lartpërmendura ka pasur ide për projekte ku mund të angazhohen ato në dizajnimin dhe realizimin e projekteve që lidhen me aktivitetet e natyrës dhe nevojave të tyre e që pa dyshim janë të shumta.

Iniciativat ekzistuese:

Edhe pse një numër i konsiderueshëm i femrave punojnë në sektorë të ndryshëm për çka konsiderohet se numri është i kënaqshëm, poashtu ka gatishmëri dhe potencial që shumë femra të shkolluara dhe pa obligime kanë vullnet që të angazhohen në ndonjë punë. Është edhe mundësia e angazhimit në punë dore, ose projekte që kanë të bëjnë me rrobaqepësi, sallone ondulimi apo çfarëdo pune tjetër. Në fshatin Videjë ka një organizatë multietnike të femrave me emrin "Indira" që mbledhë gratë e të gjitha komuniteteve, dhe e cila është krijuar me donacione të organizatave vendore kosovare dhe donatorëve.

Edhe Interesos ka pasur një iniciativë të organizimit të grave në qytetin e Klinës në periudhën menjëherë pas kthimit, por ajo pas një periudhe të shkurtë është shuar tashmë. Veç kësaj deri më tani nuk ka pasur ndonjë iniciativë serioze që të aktivizohen ato dhe që të ndikohet që femrat të jenë faktor i barabartë në aspekt të punësimit me gjininë mashkullore.

Në fshatrat Videjë, Bërkovë, Grapc dhe Binçë ka mjaft gra për aktivizimin e tyre në projekte ose aktivitete të ndryshme por deri tani nuk ka asnjë iniciativë të grave që është realizuar ose që është e përkrahur nga ndonjë donator i huaj apo institucion lokal.

Rekomandime për veprime mëtejme:

- Të krijohet sa më shumë hapësirë për përfshirjen e femrës së komunitetit serb në aktivitetet politike e shoqërore
- Ta organizohen kurse për femrat, kurse për kompjuterët, internetin etj, por edhe kurse të aftësisimit në profesione të ndryshme
- Të krijohen mundësi punësimi për femrat
- Të përkrahen idetë e organizatave të grave dhe që kanë të bëjnë më femrat
- Të futen në funksion kapacitetet ekzistuese posaçërisht në fshatrat Videjë dhe Grapc ku gratë mund të kontribuojnë shumë



III. Ndërhyrja në komunitet

3.1 Hyrje

Kjo pjesë e kësaj strategjie ka të bëjë me qasja nëpër lokalitete të ndryshme, me projekte të veçanta nëpër lagje dhe fshatra të komunës së Klinës. Kryesisht më të shpeshta në këtë pjesë janë projektet për infrastrukturën, projektet e infrastrukturës, bujqësinë, zhvillimin ekonomik, etj. Në këtë pjesë gjatë hartimit të strategjisë bashkë me komunitetin SiV ka tentuar të bëjë edhe përlllogaritjen e përafërt të kostos së implikimit buxhetor për projektet e veçanta.

Në këtë mënyrë këto kërkesa të komunitetit kanë marrë formën e mini projekteve, në të cilat sipas një modeli të përbashkët janë përcaktuar disa kërkesa si kostoja e përafërt e llogaritur e çmimit, objektivat dhe qëllimet, përfituesit, etj. Këto të dhëna janë konsideruar si pasqyrë e parë për t'u paraqitur para komunës dhe donatorëve për të matur mundësinë e angazhimit financiar.

Zbatimi i këtyre projekteve zbut problemet më të dukshme të komunitetit që bien në sy në shikim të parë në vendet ku jeton, por nuk i zgjodh në përgjithësi problematikat lidhur me komunitetin, prandaj kjo pjesë e tretë e kësaj strategjie duhet parë si shtojcë e pjesës së dytë në të cilin jepen rekomandimet.

Në këtë listë projektsh janë përfshirë tetë lokalitetet kryesore, ato fshatra ku kërkesat e komunitetit mund të artikulohen dhe të shprehen para donatorëve.

1. Qyteti i Klinës

Në vetë Klinën kanë jetuar rreth 554 familje serbe me rreth 2300 anëtarë. Kthimi ka filluar që nga në viti 2002, ku së pari të kthyerit janë vendosur se pari në Binçë, e pastaj nga fillimi i vitit 2004 janë kthyer në shtëpitë dhe banesat e tyre në qytet duke e bërë qytetin e parë në Kosovë ku zhvillohet kthimi. Deri tani numri i të kthyerve tregon se janë 117 familje, të cilave iu janë rinovuar shtëpitë dhe banesat. Po ashtu nga UNDP-ja dhe Qeveria e Kosovës janë ndërtuar 6 shtëpi si dhe një nga DRC-ja. Nga numri i cekur i të kthyerve rregullisht në Klinë qëndrojnë diku mes afër 40 vetë, kryesisht të moshuar. Njerëzit që kanë punuar në institucione shtetërore ishin të punësuar nga shteti duke punuar në administratë dhe sektorë tjerë, përfshirë ndërmarrjet shoqërore, por të ardhura shumica e anëtarëve të këtij komuniteti kishte edhe nga bujqësia dhe blegtoria, pasi shumica prej tyre kanë prona bujqësore në periferi të qytetit në zona të mira bujqësore. Tanimë një numër i vogël merret më këtë punë që dukur ishte e leverdishme. Tani prodhojnë vetëm për nevoja e veta, përndryshe kryesisht jetojnë nga pensionet dhe të ardhurat tjera sociale. Banorët deri tani kanë marrë disa donacione nga anët e ndryshme duke filluar nga Zyra për Komunitete e Komunës Klinë që ka dhuruar orendi shtëpiake për familje. Qendra Koordinuese iu ka shpërndarë pasjeje elektroshtëpiake pajisje për kuzhinë dhe banjo, DRC-ja ka shpërndarë krevate për 30 familje si dhe aparaturo për punë për saldim, zdrukthëtarë dhe makineri. Manastiri i Deçanit një traktori ma pajisjet shtesë të nevojshme, e ma vonë 7 frigoriferë dhe një kombibus. Unija-M po ashtu një traktor si dhe IOM-i ka pajisur një punëtorë për automekanik.

Titulli i projektit: Asfaltimi i rrugës "Marie Shllaku"

Sektori: Infrastruktura

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Klinë

Buxheti: 30 000 Å

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim përmirësimin e infrastrukturës rrugore për komunitetin e kthyer në këtë lagje të qytetit duke lehtësuar qarkullimin e tyre dhe duke u krijuar kushte më të favorshme për jetesë në atë zonë ku graviton një numër i madh i banorëve të kthyer.

Objektivat:

- Asfaltimi i rrugës në lagjen "Marie Shllaku"
- Krijimi i kushteve më të mira të jetesës dhe qarkullim më të lehtë për komunitetin serb
- Kujdesi i barabartë ndaj gjithë qytetareve nga institucionet pa marrë parasysh përkatësinë etnike

Përfituesit:

Përfituesit në këtë projekt do të jenë banorët e kësaj lagjeje, sidomos komuniteti serb që është kthyer në atë pjesë, si dhe komunitete tjera në atë lagje.

Qasja:

Fillimisht do të bëhet nivelimi i rrugës që do të fillojë nga rruga kryesore afër sheshit "Nëna Terezë" dhe do vazhdojë deri në qendër të lagjes, në një gjatësi prej 400 metra dhe në një gjerësi prej 4 metrave. Pasi të jetë kryer nivelimi do të bëhet asfaltimi i saj.

Titulli i projektit: Kanalizimi i ujërave të zeza

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Klinë

Buxheti: 15 000 €

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim kanalizimin e ujërave të zeza, duke e lidhur këtë lagje në rrjetin e kanalizimit të qytetit, duke krijuar një ambient më të sigurt shëndetësor dhe një jetë më të mirë.

Objektivat:

- Kycja në rrjetin e kanalizimit të qytetit
- Eliminimi i rrezikut nga sëmundjet e ndryshme infektive
- Krijimi i një ambienti të pastër dhe të shëndoshë për jetën normale për banorët e lagjes
- Eliminimi i ujërave të zeza nga sipërfaqja e tokës

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jetë komuniteti serb që jeton në rrugën ish-Rifat Burxhoviqit që gjendet në brendësi të qytetit, pjesë kjo ku është bërë kthimi i këtij komuniteti, e po ashtu përfitues nga ky projekt janë edhe komunitetet tjera pasi kjo lagje është popullarizuar më komunitete të ndryshme.

Qasja:

Do të fillohet ndërtimi i kanalizimit në këtë lagje, pasi asnjëherë nuk ka pasur kanalizim për ujëra të zeza, do të bëhet kycja e të gjitha shtëpive që ujërat e zeza të derdhen aty dhe ky kanalizim do të lidhet në rrjetin e kanalizimit të qytetit. Përmes këtij projekti kjo lagje do të zgjidhte këtë problematikë shumë vjeçare të kanalizimit të ujërave të zeza, që paraqet rrezik për jetën e banorëve në këtë lagje.

Titulli i projektit: Kanalizimi i ujërave atmosferike

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Klinë

Buxheti: 20 000 Å

Qëllimi i projektit:

Eliminimi i përmbytjeve të rrugëve dhe lagjes nga të reshurat atmosferike, pasi nga mungesa e një kanalizimi të tillë shpesh rrugët e kësaj lagje bëhen të pa kalueshme për këmbësorë, duke vështirësuar jetën e banorëve të kësaj lagjeje për një qarkullim normal.

Objektivat:

- Qarkullim më i mirë të këmbësorëve
- Kanalizim të ujërave atmosferike që vinë nga të reshurat atmosferike
- Rrugë të kalueshme për këmbësorë gjatë stinës së të reshurave

Përfituesit:

Përfitues do të ishte se pari komuniteti serb i rrugës ish-Rifat Burxhoviqit, që gjendet në brendësi të qytetit të Klinës ku është i koncentruar një numër i konsiderueshëm i të kthyerve nga ky komunitet, poashtu ka edhe pjesëtarë të komuniteteve tjera që e përbejnë këtë pjese si lagje shumë-etnike.

Qasja:

Me këtë projekt do të bëhet ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për ujërat atmosferike në rrugë në gjatësi përafërsisht 250 metra që do lidhej me rrjetin aktual të lagjeve tjera.

Titulli i projektit: Ndërtimi i një depoje për mjete bujqësore

Sektori: Bujqësia

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Klinë

Buxheti: 28 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Sigurimi i hapësirës për strehimin dhe ruajtjen e pajisjeve bujqësore si dhe krijimin e kushteve më të mira për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e tyre që drejtpërsëdrejti krijon një bazë të mirë për zhvillimin e bujqësisë dhe ekonomisë së këtij komuniteti të kthyer.

Objektivat:

- Sigurimi i hapësirës për strehimin e pasurisë së përbashkët të komunitetit
- Krijimi i kushteve për vetorganizim të avancuar të komunitetit minoritar në sferën e bujqësisë
- Përmirësimi i kushteve ekonomike për komunitetin e kthyer
- Stimulimi i formave të organizimit në veprim ndaj bujqësisë dhe ngritja e gjendjes materiale të komunitetit
- Sigurim i ekzistencës dhe ngritje të gjendjes materiale të komunitetit në fokus

Përfituesit:

Projekti është i fokusuar ndaj komunitetit serb që jeton në pjesën urbane të komunës së Klinës e që jeton dhe varet kryesisht nga bujqësia dhe varen nga kushtet e gjendjes së kësaj sfere e që është ngushtë lidhur me bujqësi, blegtori e fusha tjera bujqësore.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të ndërtohet një depo në një gjatësi prej 10 metrash dhe në një gjerësi prej 7 metrave, më pas do të bëhet edhe rrethimi i saj me rrethoja hekuri. Ky objekt do t'u shërbejë të gjithë banorëve të kësaj lagje që pajisjet e tyre t'i vendosin në një ambient më të sigurt, dhe përmes kësaj komuniteti do të jetë më i organizuar në shfrytëzimin e pajisjeve bujqësore, dhe do të kenë mundësi që të rrisin prodhimtarin e tyre bujqësore gjë që ndikon edhe në zhvillimin ekonomik familjar.

2. Fshati Dërsnik

Fshati Dërsnik ka numëruar 180 amvisëri me nga 780 anëtarë të komunitetit serb, si dhe nga 30 familje shqiptare. Gjendet në 2,2 km nga qendra e qytetit të Klinës dhe kufizohet më Klinën dhe fshatrat Gremnik, Dollc, Perqevë, Gllarevë, Gjurgjëvik, Pogragjë e Klinavc. Nga objektet publike këtu ekziston një objekt kishtar, ndërsa fshati është i përbërë nga rreth 4000 hektarë pyll si dhe 2000 hektar sipërfaqe tjetër.

Kthimi është zhvilluar gjatë vitit 2005, ndërsa nga UNDP-ia, Qeveria e Kosovës dhe ICMC-ia janë ndërtuar 40 shtëpi nga ato 30 deri 35 anëtarë janë vazhdimisht aty e poashtu ka edhe fëmijë.

Popullata këtu kryesisht ka jetuar nga bujqësia dhe blegtoaria, e një pjesë dërmuese ka qenë e punësuar në ndërmarrjet shoqërore të asaj kohe.

Ndërsa, përveç donatorëve të lartpërmendur, janë ndihmuar nga DRC-ja me dru për ngrohje dhe pajisje elektronike për amvisëri. Manastiri i Deçanit u ka dhënë një traktor me mjete shtesë, ndërsa Serbia me Qendrën Koordinuese iu kanë dhuruar një traktor me mjete shtesë, 30 karroca ndërtimtarie, mjete punës për të punuar tokën si dhe pajisje të elektroteknikës për 22 amvisëri. Poashtu UNDP-ICMC-u u ka dhuruar mjete në vlerë deri 700 Å krijimin e kushteve për banim. UNHCR-i dhe AED-i përmes OJQ-së "ARUD" iu kanë dhënë një traktor dhe motokultivator.

Titulli i projektit: Ndërtimi i rezervuarit për ujë të pijshëm

Sektori: Shëndetësia

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Dërsnik, Klinë

Buxheti: 20 000 Å

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim që komunitetit t'i sigurojë ujë të mjaftueshëm për pije dhe kushte elementare për një jetë normale

Objektivat:

- Furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijshëm
- Krijimi i kushteve elementare për mirëmbajtje të higjienës personale dhe publike
- Krijimi i kushteve elementare për kthim të qëndrueshëm të komunitetit

Përfituesit:

Përfituesit nga ky projekt do të jetë komuniteti serb i fshatit Dërsnik që është i përbërë nga grup-moshat dhe gjinitë e ndryshme

Qasja:

Përmes këtij projekti në kodrinën e fshatit do të ndërtohet një rezervuar me një gjerësi prej 4 metrave dhe gjerësi po ashtu prej 4 metrave dhe me një thellësi 3 metra. Përmes këtij rezervuari banorët e këtij fshati do të ju sigurohet ujë i mjaftueshëm për pije dhe për nevojat e tyre elementare.

Titulli i projektit: Rregullimi i rrjetit elektrik

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Dërsnik, Klinë

Buxheti: 10 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim që të riparojë rrjetin e fshatit për t'u siguruar banorëve të kësaj zone rrymë të mjaftueshme dhe siguri më të madhe, pasi që rrejtja aktual e rrymës është i vjetruar dhe vazhdimisht shkakton probleme në fshat, duke mos pasur furnizim të mjaftueshëm me rrymë.

Objektivat:

- Furnizimi i mjaftueshëm dhe kualitativ më rrymë elektrike
- Sigurimi i mirëqenies sociale dhe ekonomike për fokus grupin
- Eliminimi i problematikave të ndryshme e të shpeshta nga prishjet e ndryshme në sistemin e rrjetit furnizues dhe prishjet e shpeshta në rrjetin shpërndarës
- Krijimi i një infrastrukture zhvillimore dhe të qëndrueshme të furnizimit me rrymë

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë banorët e komuniteti serb të kthyer në fshatin Dërsnik të komunës së Klinës, pasi që në këtë fshat një numër i konsiderueshëm i banorëve përballet me këtë problem.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet ndërrimi i të gjitha shtyllave të rrymës nëpër fshat si dhe telave që përçojnë rrymën, pasi që rrejtja aktual nuk siguron rrymë për banorët e këtushëm dhe vazhdimisht duhet të behen intervenime në sanimin e problemeve që rrezikojnë edhe jetën e banorëve të këtij lokaliteti.

Titulli i projektit: Kanalizimi i ujërave të zeza

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Dërsnik, Klinë

Buxheti: 60 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim ndërtimin e kanalizimit në fshatin Dërsnik, me çka për banorët e këtij fshati zgjidhet problemi i ujërave të zeza që rrjedhin në sipërfaqet publike nëpër rrugët e fshatit dhe krijohet një ambienti më i mirë ekologjik dhe shëndetësor

Objektivat:

- Ndërtimi i kanalizimit të fshatit
- Kanalizimi i ujërave të zeza në vendet adekuate
- Krijimi i një ambienti më të pastër
- Rritja e sigurisë shëndetësore nga sëmundjet infektive

Përfituesit:

Përfituesit do të jenë banorët e këtij lokaliteti sidomos komuniteti serb, pasi me ndërtimin e kanalizimit anashkalohet problematika e ujërave të zeza, gjë që do të ndikojë në ruajtje të ambientit dhe shëndetit të tyre.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të fillojë ndërtimi i kanalizimit në një gjatësi prej 2 kilometra, nga qendra e fshatit në drejtim të rrjetit të kanalizimit të qytetit, ku do të kyçen 40 shtëpi për të bërë derdhjen e ujërave të zeza.

Titulli i projektit: Renovimi i Shtëpisë së kulturës

Sektori: Kulturë

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Dërsnik, Klinë

Buxheti: 40 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Në kuadër të këtij projekti do të rinovohet i tërë objekti dhe do të shndërrohet në një objekt të përshtatshëm për të zhvilluar aktivitete të ndryshme kulturore dhe rekreative nga të rinjtë e komunitetit serb.

Objektivat:

- Krijimi i hapësirës për aktivitete të lira për të rinj
- Zhvillimi i kulturës së këtij komuniteti përmes aktiviteteve kulturore
- Ofrimi i kushteve për aktivitete rinore argëtuese për të rinjtë e këtij fshati dhe fshatrave të tjera

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë banorët e këtij fshati, sidomos komuniteti serb, por edhe komunitet tjera që jetojnë në këtë fshat dhe fshatrat përreth. Përfitues direkt do të jenë të rinjtë e këtij lokaliteti pasi do t'u ofrohen mundësi për t'u marrë më shumë me aktivitete kulturore dhe rekreative.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet ndërrimi i kulmit të objektit ekzistues, renovimi i ambientit përbrenda, ndërrimi i dyerve dhe dritareve si dhe rregullimi i nxehjes së objektit si dhe rregullimi i hapësirës përpara ndërtesës.

3.Fshati Binçë

Fshati Binçë është fshati i parë ku ka filluar kthimi në komunën e Klinës duke filluar në vjeshtën e vitit 2002. Në fshat para luftës jetonin 150 familje serbe më rreth 460 anëtarë.

Deri më tani për serbët dhe malazezët e këtushëm nga ana e THW-së dhe UNDP-së janë ndërtuar 45 shtëpi e nga gjitha këto janë të banuara diku rreth 10 shtëpi, që përbën diku 15 deri 20 anëtarë që vazhdimisht qëndrojnë këtu. Në fshat poashtu jetojnë edhe disa familje më përkatësi egjiptiane. Binça gjendet mes fshatrave Grapc, Shtupel, Drenovc nga komuna e Klinës si dhe me Ozrimin e Komunës së Skenderajt. Nga ky fshat në institucione të komunës dhe nëpër ndërmarrje të Klinës kanë punuar disa dhjetëra të punësuar përfshirë edhe administratën dhe policinë.

Që prej kthimit ka pasur mjaft donacione për të kthyerit. Komuna iu ka dhuruar një traktor me mjete shtesë për punë në bujqësi, AKTED-i iu ka dhënë traktorin me rimorkio si dhe mjetet shtesë për mbjellje e korrje. IOM-i ka ndihmuar krijimin fondit blegtoral duke dhuruar lopë, dele e pula.

Mercy Corps-i ka asfaltuar rrugën në gjatësi nga 3 km. Mercy Corps ka dhuruar edhe një mikser për përzierje dhe prodhim të koncentratit, mullirin e gurit dhe pajisjet tjera shtesë për punë në bujqësi.

Titulli i projektit: Zëvendësimi i rrjetit elektrik

Spektori: Infrastruktura

Afati kohor: 1 muaj (duke filluar në vitin 2012)

Vendi: Binçë, Klinë

Buxheti: 15 000 Å

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për synim që të bëjë ndërrimin e rrjetit elektrik të fshatit, saktësisht zëvendësimi e disa shtyllave dhe telave që përçojnë rrymën në fshat me tela të rinj.

Objektivat:

- Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike
- Riparimi i rrjetit elektrik dhe shtyllave
- Eliminimi i prishjeve të shpeshta dhe rrezikimit të jetës së banorëve
- Përmirësimi i kushteve të jetesës për banorët e fshatit Binçë

Përfituesit:

Përfituesit e këtij projekti janë pjesëtarët e komunitetit serb që jetojnë në këtë fshat të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet zëvendësimi i disa shtyllave të drurit jo adekuate me shtylla betoni si dhe ndërrimi i tërë telave përçues të rrymës, pasi rrjeti aktual nuk siguron rrymë të mjaftueshme dhe vazhdimisht ka prishje që shpesh rrezikojnë edhe jetën e banorëve të këtij lokaliteti.

Titulli i projektit: Rregullimi i Shtëpisë së Kulturës

Sektori: Kulturë

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Binçë, Klinë

Buxheti: 40 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Rregullimi dhe futja në funksion e Shtëpisë së Kulturës që ekziston në fshatin Binçë, krijimi i kushteve të favorshme për kultivimin e traditës dhe zakoneve të komuniteti të kthyer, përfshirë edhe një numër të rinjve që iu nevojitet hapësira për aktivitete të ndryshme argëtuese

Objektivat:

- Vënia në funksion të shtëpisë të kulturës
- Krijimi i kushteve elementare për ruajtjen e kulturës, traditës, zakoneve të komunitetit serb
- Ofrimi i kushteve për aktivitete rinore argëtuese për të rinjtë e këtij dhe fshatrave të tjera
- Krijimi i hapësirës për aktivitete të ndryshme për gratë e komunitetit të kthyer

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë të gjithë banorët e këtij fshati jo vetëm komuniteti serb, por edhe fshatrat në afërsi të Binçës, e sidomos të rinjtë e këtij fshati do të ju ofrohet mundësi për tu marr më shumë me aktivitet të ndryshme kulturore e rekreative. Po ashtu ky objekt do të shërbejë edhe si vend takim i të rinjve për t'u argëtuar dhe për të zhvilluar kulturën e tyre.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të sanohen dëmtimet që i janë bërë këtij objekti, do të bëhet ndërrimi i dyerve dhe dritareve, do të ndërtohet rrethoja e objektit për shkaqe sigurie si dhe do të bëhet pajisja me inventar të nevojshëm, që ofron kushte për të zhvilluar aktivitete të ndryshme dhe për të qenë funksional.

Titulli i projektit: Rregullimi i rrugës së fshatit

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Binçë, Klinë

Buxheti: 6 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim ndërtimin e rrugës së fshatit që është në gjendje të keqe, duke ofruar kushte më të mira për banorët e këtij lokaliteti për të pasur një qasje më të lehtë në udhëtim.

Objektivat:

- Rregullimi dhe zgjerimi i rrugës
- Shtrimi i rrugës me zhavorr
- Krijimi i një ambienti më të favorshëm për të jetuar në atë lokalitet

Përfituesit:

Përfitues nga ky projekt janë komuniteti serb që jeton në këtë pjesë të fshatit Binçë, e sidomos fëmijët pasi që gjatë stinës së të reshurave kjo rrugë bëhet e pa kalueshme për këmbësorë.

Qasja:

Projekti synon që të ndërtojë një rrugë të fshatit që ndodhet në hyrje të fshatit, saktësisht në anë e majtë në një gjatësi rreth 400 metra dhe gjerësi prej 4 metrave. Fillimisht do të bëhet nivelimi i saj dhe më pas do të bëhet shtrimi i saj me zhavorr që banorët e këtushëm të qasen në rrugën kryesore të asfaltuar.

4. Fshati Bërkovë

Fshati Bërkovë gjendet në rrugën kryesore Klinë- Gurrakoc dhe kufizohet me fshatrat Zllakuqan dhe Rudicë nga komuna e Klinës deri sa me komunën e Istogut me fshatrat Kosh dhe Drëjë. Në këtë fshat para luftës kishte 80 shtëpi të banuar përafërsisht me 250 banorë të komunitetit serb, gjithashtu ishin edhe 13 familje shqiptare dhe 2 familje të komunitetit egjiptian.

UNDP dhe DRC kanë ndërtuar 34 shtëpi prej të cilave vetëm 17 janë të banuara me mbi 25 të kthyer. Fshati posedon 300 hektarë sipërfaqe tokë bujqësore, përveç bujqësisë dhe pylltarisë, të ardhurat materiale i kanë fituar edhe nëpërmjet punësimit në institucione shtetërore dhe ndërmarrjet shoqërore që akne ekzistuar.

Nga Organizata Mercy Corps dhe USAID kanë përfituar nga një traktor, për të dy fondet Kuvendi Komunal u ka siguruar mekanizmin. UNDP u ka dhënë grante të gjitha 24 familjeve të kthyer nga 2.000 euro për mjete, ndërsa Manastiri i Deçanit ju ka dhuruar një kombibus.

Slllovenet ju kane ndërtuar stallën dhe garazhin, rrugën në gjatësi 500 metra si dhe urën për Rudicë. UNDP gjithashtu ka ndërtuar rrugën në gjatësi 2 kilometra.

Titulli i projektit: Ndriçimi rrugor për fshatin

Spektori: Infrastruktura

Afati kohor: 1 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Bërkovë, Klinë

Buxheti: 12 000 Å

Qëllimi i projektit:

Përmes këtij projekti do të rritet siguria e komunitetit gjatë natës dhe do të krijohen kushtet për lëvizje të lirë edhe në orët e vona të mbrëmjes në atë lokalitet.

Objektivat:

- Rritja e sigurisë së komunitetit për të udhëtuar në këmbë në mbrëmje
- Ndriçimi i disa rrugëve të fshatit
- Krijimi i parakushteve dhe ndjenjës për siguri fizike të të kthyerve
- Parandalimi i vjedhjeve në fshat

Përfituesit:

Përfitues do të jenë të gjithë banorët e këtij fshati dhe të fshatrave përreth që kalojnë gjatë orëve të mbrëmjes nëpër këtë lokalitet, sidomos këmbësorëve.

Qasja:

Do të bëhet ndriçimi i një pjese të rrugës kryesore Klinë - Gurrakoc që ndan fshatin në dy pjesë si dhe ndriçimi i dy rrugëve brenda fshatit, në një gjatësi diku prej 4 kilometra duke i përfshirë rrugën kryesore dhe dy rrugë të fshatit.

Titulli i projektit: Restaurimi i Shtëpisë së kulturës

Sektori: Kulturë

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Bërkovë, Klinë

Buxheti: 15 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Restaurimi i Shtëpisë së kulturës që ekziston në fshatin Bërkovë krijon kushte të favorshme për kultivimin e traditës dhe zakoneve të komunitetit të kthyer, më konkretisht edhe për një numër të rinjve që iu nevojitet hapësira për aktivitete të ndryshme argëtuese.

Objektivat:

- Kthimi në funksion të shtëpisë së kulturës dhe rritja e aktiviteteve të ndryshëm kulturore e artistike në këtë lokalitet
- Krijimi i kushteve elementare për ruajtjen e kulturës, traditës, zakoneve të komunitetit serb
- Ofrimi i kushteve për aktivitete rinore argëtuese për të rinjtë e këtij lokaliteti dhe fshatrave tjera
- Krijimi i hapësirës për aktivitete të ndryshme për gratë e komunitetit të kthyer

Përfituesit:

Komuniteti serb i fshatit Bërkovë dhe fshatrave tjera të këtij dhe komuniteteve tjera ku përfshihen grup-moshat dhe gjinitë e ndryshme.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet renovimi i hapësirave të brendshme të objektit, izolimi i nevojshëm si dhe pajisja me inventar adekuat për të zhvilluar aktivitete të ndryshme.

Titulli i projektit: Rregullimi i Rrugës së kodrës

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Bërkovë, Klinë

Buxheti: 8 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim të rregullojë infrastrukturën rrugore për komunitetin e kthyer që jeton në fshatin Bërkovë dhe e shfrytëzon rrugën e gjatë afro 2 kilometra e fshatit (ka Kodra) ku graviton një numër i konsiderueshëm i këtij komuniteti.

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës rrugore në fshatin Bërkovë
- Krijimi i kushteve më të mira të jetës dhe qarkullimit për komunitetin serb
- Krijimi i kushteve për punimin e tokave bujqësore në një pjesë të fshatit Bërkovë

Përfituesit:

Përfituesit në këtë projekt do të jenë anëtarët e komunitetit serb ku përfshihen grup-mosha të ndryshme si dhe të dy gjinitë si dhe komunitetet tjera që jetojnë aty.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të fillojë zgjerimi i rrugës që shtrihet në kuadër të fshatit në një gjatësi prej 2 kilometra dhe një gjerësi prej 4 metrave. Fillimisht do të bëhet nivelimi dhe rrafshimi me makineri të nevojshme dhe më pas do të bëhet shtrimi i saj me zhavorr.

Titulli i projektit: Asfaltimi i Rrugës së varrezave

Spektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2014)

Vendi: Bërkovë, Klinë

Buxheti: 7 000 Å

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për synim asfaltimin e rrugës së një pjese të fshatit me rrugën kryesore, për të krijuar një ambient më të mirë për udhëtim pasi banorët e këtij lokaliteti janë të detyruar të përdorin rrugë dytësore për t'u qasur në rrugën kryesore.

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës rrugore në fshatin Bërkovë
- Riparimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatit
- Krijimi i kushteve më të mira jetesës dhe qarkullimit për komunitetin serb
- Krijimi i kushteve për punimin e tokave bujqësore në pjesë të fshatit Bërkovë

Përfituesit:

Përfituesit në këtë projekt do të janë anëtarët e komunitetit serb, përfshirë grup-moshat e ndryshme si dhe të dy gjinitë si dhe një numër të komuniteteve tjera që jetojnë aty.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet asfaltimi i rrugës në një gjatësi prej 1.5 kilometra, që do të fillohet nga rruga kryesore dhe do të përfundojë në qendër të fshatit. Pasi kjo rrugë është e pa kalueshme si për këmbësorët ashtu edhe për makinerinë bujqësore, gjë që detyron banorët e kësaj pjese të fshatit të përdorin rrugë alternative për të pasur qasje në qytet dhe në tokat e tyre bujqësore që shtrihen përbuzë rrugës kryesore Klinë-Gurrakoc.

5. Fshati Rudicë

Në këtë fshat kanë jetuar përafërsisht 25 familje me diku 100 anëtarë të komunitetit serb, 15 egjiptian si dhe 30 shtëpi të komunitetit shqiptar.

Gjatë vitit 2009 në fshat nga UNDP janë ndërtuar 10 shtëpi, deri sa aty nga komuniteti i kthyer jetojnë diku 13 banorë. Fshati gjendet afër lumit të Istogut, i cili e ndanë rrugën magjistrale Klinë- Gurrakoc dhe kufizohet me Bërkovën, Zllakuqanin dhe Budisalcin në Klinë dhe me Zallqin dhe Zabllaqin, fshatra të Komunës së Istogut. Ata të cilët kanë qenë të punësuar kanë punuar në kompanitë shtetërore.

Rudica me projekte është mbështetur nga disa donatorë. Mercy Corps si donacion u ka dhuruar mbjellëse dhe nxjerrëse të patateve, deh disa pajisje rëndësishme për bujqësi për arat dhe livadhet. Donacioni i lartpërmendur ka qenë pjesë e projektit të përbashkët (programi balancues) ku kanë përfituar bashkë me komunitetin shumicë. Gjithashtu UNDP ka dhënë si donacion një traktor.

Titulli i projektit: Pastrimi i shtratit të lumit

Sektori: Bujqësi

Afati kohor: 1 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Rudicë, Klinë

Buxheti: 8 000 Å

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim pastrimin e shtratit të lumit të Istogut i cili shpesh herë del jashtë shtratit të tij dhe shkakton dëme të ndryshme në fushat e punuara bujqësore e që janë burimi kryesor i të ardhurave materiale të komunitetit që jeton këtu.

Objektivat:

- Eliminimi i rrezikut që vjen nga vërshimet e Lumit të Istogut në fshatin Rudicë
- Krijimi i sigurisë për investime bujqësore në fshatin Rudicë
- Përkrahja institucionale e bujqve serb të fshatit Rudicë
- Përkrahja e jetës në viset rurale

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti do të jenë banorët e këtij fshati dhe të fshatrave tjerë, pasi që do të krijohet një siguri për kulturat e tyre bujqësore gjatë stinës së reshjeve.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet zgjerimi dhe thellimi i shtratit të lumit Istogu në gjatësi prej rreth 1 kilometër që kalon kah tokat bujqësore të këtij fshati, si dhe do të bëhet prerja e lisave që shkaktojnë devijimin e rrjedhjes së lumit. Për mes këtij projekti do të rritet prodhimtaria e kulturave bujqësore, do të parandalohet edhe dëmtimi i tokave bujqësore nga vërshimet.

Titulli i projektit: Ujësjetësi për fshat

Spektori: Infrastruktura

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Rudicë, Klinë

Buxheti: 30 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim që të zgjidhë problematikën e mungesës së ujit të pijes jo vetëm për komunitetin serb por edhe për komunitetet tjera që jetojnë këtu.

Objektivat:

- Ndërtimi i rrjetit të ujësjetësit në vendbanime të reja
- Furnizimi me ujë të pijshëm në fshatin Rudicë
- Stimulimi i qëndrimit në vende rurale dhe krijimi i kushteve elementare për një jetë më cilësore

Përfituesit:

Përfituesit nga ky projekt do të jenë komunitetet e ndryshme që jetojnë në këtë fshat dhe fshatrave tjera, posaçërisht për komunitetin serb por edhe për gjithë tjerët që jetojnë këtu.

Qasja:

Përmes këtij projekti do të bëhet zgjerimi i rrjetit të ujësjetësit nga rrjeti i qytetit në këtë fshat në një gjatësi rreth 4 kilometra dhe kështu do të sigurohet ujë i mjaftueshëm për pije për komunitetin që jeton në këtë lokalitet.

Titulli i projektit: Rregullimi i rrugës që lidhë fshatrat Rudicë-Berkovë

Spektori: Infrastruktura

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Rudicë, Klinë

Buxheti: 10 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim rregullimin e rrugës me qëllim krijimin e kushteve më të mira në infrastrukturë për komunitetet që jetojnë në këto dy fshatra.

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës rrugore të fshatrave Rudicë e Berkovë
- Përmirësimi i komunikacionit të kësaj pjesë
- Krijimi i rrugëve më të shkurta dhe më të përshtatshme për destinime tjera dhe në magjistralen Klinë-Gurakoc
- Krijimi i kushteve më të mira si bazë e ardhshme zhvillimore për këto fshatra dhe fshatrat përreth.

Përfituesit:

Përfituesit nga ky projekt do të jenë komunitetet e këtyre dy fshatrave si dhe të gjithë banorët e këtyre dy fshatrave dhe fshatrave të tjera përreth që i lidh kjo rrugë.

Qasja:

Projekti sheh shtrimin dhe zgjerimin e rrugës aktuale të kësaj rrugë që në gjendjen se si është tani është e vështirë për t'u kaluar. Rruga do nivelohet dhe shtrohet me zhavorr në gjatësi prej dy kilometra në mënyrë që përmes kësaj rruge të lidhen drejtpërdrejt dy fshatrat, ku kryesisht jeton komuniteti serb.

6. Fshati Dollc

Në fshatin Dollc para luftës kanë jetuar 60 familje serbe më diku 256 anëtarë si dhe 20 familje shqiptare, numri i të cilave tash është dyfishuar. Në vitin 2009 janë kthyer 12 familjet e para serbe me rreth 14 anëtarë. Dollci është 4 kilometra larg pjesës urbane të Klinës dhe është i rrethuar nga fshatrat Gremnik, Gllarevë dhe Dërsnik.

Para luftës popullata serbe ka qenë kryesisht e punësuar në ndërmarrjet shoqërore, kurse pjesa tjetër është marrë kryesisht me pylltari, bujqësi dhe blegtori. Këta sektor janë edhe tash mundësi për zhvillimin e tyre, sepse fshati ka tokë dhe është një përrua me ujë të mjaftueshëm për ujitje. Dikur ka pasur edhe një mulli, i cili është shkatërruar dhe DRC-a tani po interesohet që ta rinovojë dhe që me ngritjen e kapacitetit, të shërbejë për tërë regjionin.

Në fshat ekziston shkolla fillore e re, që rri e pa shfrytëzuar, poashtu një shtëpi kulture, që mund të rinovohet. Përveç shtëpive që janë ndërtuar nga Këshilli Danez për Refugjatë (DRC) banorët e fshatit se shpejti do të përfitojnë me disa mjete pune për bujqësi.

Titulli i projektit: Restaurimi i Shtëpisë së kulturës

Sektori: Kulturë

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Dollc, Klinë

Buxheti: 30 000 Å

Qëllimi i projektit:

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i kushteve më të mira për të rinjtë e fshatit dhe në përgjithësi për të gjithë banorët e fshatit, të cilët nuk kanë kushte të mjaftueshme për të realizuar aktivitete kulturore dhe rinore.

Objektivat:

- Krijimi i kushteve për aktivitete të ndryshme kulturore për komunitetin, posaçërisht për gratë dhe rininë
- Stimulimi i kulturës dhe përkrahja e saj në mënyrë adekuate për të promovuar iniciativat e shoqërisë civile
- Avancimi i raporteve ndëretnike përmes aktivitete rinore

Përfituesit:

Përfitues të drejtpërdrejtë të projektit do të jetë gjithë komuniteti, posaçërisht të rinjtë dhe femrat e fshatit dhe fshatrave të tjerë përreth, të cilët do të kenë mundësinë që ta shfrytëzojnë këtë objekt edhe për çështje të tjera të cilat shkojnë për të mirë të fshatit.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të rregullohen disa pjesë të objektit të dëmtuar, siç janë muret, kulmi dhe disa elemente tjera të cilat do të krijonin kushte për realizimin e aktiviteteve brenda këtij objekti. Ideja është që përmes këtij projekti komuniteti të kenë kushte më të mira dhe mundësi aktivizimi për femrat dhe të rinjtë.

Titulli i projektit: Instalimi i ndriçimit rrugor

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Dollc, Klinë

Buxheti: 10 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Synimi i këtij projekti është që të krijojë kushte më të mira për banorët e fshatit Dollc si dhe të ndikojë në sigurinë e komuniteteve.

Objektivat:

- Përmirësimi i kushteve për jetesë me ndriçim rrugor të domosdoshëm.
- Ngritja e sigurisë tek komuniteti në fokus nga rreziku i sulmit nga qentë endacakë.
- Plotësimi i nevojave të komuniteteve në aspektin e sigurisë.
- Avancimi i infrastrukturës për banorët e fshatit.

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit Dollc të cilët kanë ndër prioritetet më të para ndriçimin e rrugës, e cila ndikon direkt në sigurinë e banorëve të këtij fshati.

Qasja:

Instalimi i ndriçimit rrugor në fshatin Dollc përmes një rrjeti shtyllash elektrike në gjatësi përafërsisht një kilometër duke filluar nga rruga kryesore përgjatë qendrës së fshatit.

Titulli i projektit: Përkrahja për ndërtimin e objekteve ndihmëse në fshat

Sektori: Zhvillim ekonomik

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Dollc, Klinë

Buxheti: 2 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim lehtësimin e kushteve për ndërtimin e objekteve ndihmëse në fshat përmes dhurimit të një mjeti punës për dru, që do përdoret nga gjithë fshati për ndërtimtari.

Objektivat:

- Lehtësimi i ndërtimit në fshat
- Stimulimi i punës së përbashkët për nevojat e komunitetit për ndërtim dhe ngrohje
- Krijimi i mundësive për përmirësim të standardit jetësor në fshat

Përfituesit:

Përfitues të drejtpërdrejtë të projektit do të jetë gjithë komuniteti i fshatit Dollc, posaçërisht ata që kanë nevojë për ndërtim të objekteve ndihmëse, kasolle, stalla, etj. nga druri që ndihmojnë infrastrukturën e shtëpive të tyre që po i kompletojnë në vitin e parë pas kthimit.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti për fshatin do jepej një makinë për prerjen dhe përpunimin e masës drusore (cirkular) që do shfrytëzohej bashkërisht nga fshati për ndërtimin e objekteve ndihmëse. Pasi që për kthimin janë ndërtuar vetëm objektet e banimit, në fshat mungojnë objektet ndihmëse dhe me këtë pajisje të përbashkët, fshatarët mund të ndërtojnë vet nga materiali i drurit që ka në sasi të mjaftueshme në fshat.

Titulli i projektit: Restaurimi i rezervuarit të ujit të pijshëm

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Dollc, Klinë

Buxheti: 20 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Furnizim më i mirë me ujë të pijes për banorët e fshatit Dollc, me çka zgjidhet problemi i mungesës së ujit të pijes në fshat, për arsye se të gjithë banorët e kësaj lagjeje ku jeton komuniteti, furnizohen me ujë nga pusët.

Objektivat:

- Shfrytëzimi optimal i resurseve natyrore siç janë burimet më ujë të pijes
- Furnizimi i komunitetit më nevojat elementare si furnizimi me ujë të pijshëm
- Krijimi i kushteve më të mira për komunitetin
- Përmirësohet gjendja aktuale në aspektin shëndetësor, ambiental, bujqësor e social.

Përfituesit:

Me këtë projekt përfitojnë banorët e fshatit ku jetojnë komunitetet, po ashtu edhe të gjithë banorët të cilët jetojnë në këtë fshat duke përfshirë të gjitha komunitetet.

Qasja:

Me këtë projekt ndërhyhet me një investim jo të madh mund të kthehet në funksion rezervuarin ekzistues i ujit të pijes që është dëmtuar. Kjo do të bëhet me riparimin e dëmeve që janë shkaktuar dhe vënien e tij në funksion.

Titulli i projektit: Rregullimi i rrugës së fshatit Dollc

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Dollc, Klinë

Buxheti: 10 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim përmirësim e kushteve në infrastrukturë për fshatin Dollc. Qëllimi i projektit është të shtrojë rrugën në brendësi të fshatit që lidhet drejt me magjistralen Pejë-Prishtinë.

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës rrugore
- Krijimi i kushteve elementare për zhvillim dhe avancim të sektorëve të ndryshëm
- Vijimi i mësimin me rregull në shkollën fillore nga nxënësit e fshatit
- Krijimi i kushteve më të mira për banorët e komunitetit egjiptian

Përfituesit:

Të gjithë banorët e fshatit Dollc të cilët jetojnë në këtë fshat pa dallim etnitetin.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të shtrohet rruga që ndërlidh fshatin me rrugën magjistrale Pejë- Prishtinë. Me shtrimin e kësaj rruge krijohen kushte më të mira për banorët e komunitetit në këtë zonë. Rruga do të shtrohet me zhavorr me gjatësi deri në 1 kilometër dhe gjerësi prej 2 metrave.

Titulli i projektit: Rregullimi i kanalit të ujitjes

Sektori: Bujqësi

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Dollc, Klinë

Buxheti: 15 000 Å

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim të rregullojë kanalën e ujitjes së fshatit Dollc nga i cili ujitën gjitha tokat pjellore të cilat mbillen më kultura të ndryshme pemëve dhe perimeve.

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës për ujitje
- Krijimi i kushteve më të mira dhe afatgjate për zhvillim të bujqësisë së fshatit
- Rregullimi i shtratit të ujërave që rrjedhin nëpër fshat
- Kujdesi ndaj ujit dhe ruajtja e tij për shfrytëzim adekuat dhe të dobishëm
- Shfrytëzimi i potencialeve natyrore
- Sigurimi i kthimit të qëndrueshëm për komunitetin serb

Përfituesit:

Përfituesit do të jenë banorët e fshatit Dollc të cilët me një investim të vogël në këtë aspekt mund të kenë dobi shumë të madhe në krijimin e bazës së mirë materiale dhe familjare përmes bujqësisë.

Qasja:

Me këtë projekt përfshihet rregullimi i kanalit ekzistues që ujit tokën e fshatit në gjatësi mbi një mijë metra, nga burimi i ujit jashtë fshatit deri te tokat bujqësore në qendër të fshatit. Kanali është i dëmtuar në disa vende dhe shfrytëzimi i kapacitetit të tij është minimal.

7. Fshati Vidëjë

Në fshatin Vidëjë para luftës kanë jetuar 76 familje serbe me rreth 470 banorë si dhe 11 familje shqiptare, pos tyre Vidëja ka edhe dy lagje tjera ku jetojnë vetëm shqiptarët. Në fshat nga viti 2004 ka filluar kthimi e deri më sot Qeveria e Kosovës ka ndërtuar diku 56 shtëpi e nga ato 33 janë të banuara më një numër që për momentin është 67 anëtarë të pranishëm ku mes tyre ka edhe mjaft të rinj.

Njerëzit e këtushëm përpara kanë jetuar nga bujqësia dhe blegtoaria, ndërsa një numër një numër i madh i tyre kanë punuar në institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore.

Prej kthimit deri tani kanë marrë donacione të ndryshme për përmirësim të kushteve të jetës. Serbia iu ka dhënë traktorë me mjete përcjellëse të kompletuara për bujqësi. RTM (italiane) poashtu një traktor me mjete shtesë, ndërsa AED-USAID iu kanë japë një traktor dhe një mini traktor. Mersy Corpsi iu ka rregulluar rrugën dhe asfaltuar rreth 700 metra rrugë. DRC-ja iu ka ndërtuar ujësjellësin si dhe iu kanë bërë rekonstruimin e rrjetit elektrik.

Pos këtyre, fshati ka edhe një qendër moderne për komunitete si ndihmë e USAID-it, Mercy Corps-it dhe Komunës së Klinës, pikën grumbulluese të qumështit e tjera, përfshirë edhe kuzhinën popullore për rastet sociale e që është e ndërtuar nga ndihma e udhëheqësish së Manastirit të Deçanit. Vidëja ka shkollë fillore, rrymë, ujësjellës, funksionon telefonia fikse etj. Funksionojnë edhe disa lokale afariste, të cilët i mbajnë serbët vendas si dhe ka disa raste të ndërmarrjes së suksesshme.

Titulli i projektit: Ndriçimi rrugor në Vidëjë

Sektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Vidëjë, Klinë

Buxheti: 10 000 Å

Qëllimi i projektit:

Qëllimi i projektit është që të krijojë kushte më të mira për banorët e fshatit Vidëjë, si dhe të ndikojë në sigurinë e komuniteteve, gjegjësisht në krijimin e kushteve më të mira për nxënësit e këtij fshati.

Objektivat:

- Të krijohen siguri më e mirë në komunikacion rrugor për nxënësit të cilët gravitojnë në këtë rrugë.
- Avancimi i infrastrukturës rrugore për komunitetin vendas
- Ngritja e sigurisë për këmbësorët të rrezikuar edhe nga qetë endacakë
- Krijimi i parakushteve dhe ndjenjës për sigurim fizike të pjesëtarëve të komunitetit të kthyer.

Përfituesit:

Projekti zgjidh një problem që ka të bëjë me gjithë komunitetin e fshatit, posaçërisht nxënësit që në orët e mbrëmjes kthehen nga shkollat dhe rrezikohen nga qentë endacak.

Qasja:

Rregullimi i ndriçimit rrugor në fshatin Vidëjë që përfshin ndërtimin e një rrjeti me shtylla elektrike në gjatësi një kilometër që përfshin dy rrugët kryesore të qendrës së fshatit.

Titulli i projektit: Ndërtimi i një fushe për mini futboll

Spektori: Rini

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Videjë, Klinë

Buxheti: 2 000 Å

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim krijimin një fushe për mini futboll qe ka qenë një kërkesë e të rinjve për zhvillimin e aktiviteteve sportive.

Objektivat:

- Krijimi i kushteve për aktivitete të ndryshme sportive për komunitetin, posaçërisht për rininë
- Stimulimi i kulturës së sportit dhe përkrahja në mënyrë adekuatë e grupeve të të rinjve në aktivitete sportive
- Avancimi i raporteve ndëretnike përmes aktivitete rinore sportive

Përfituesit:

Përfitues të drejtpërdrejtë të projektit do të jetë gjithë komuniteti, posaçërisht të rinjtë e fshatit dhe fshatrave të tjerë përreth, të cilët do të kenë mundësinë që ta shfrytëzojnë këtë objekt për aktivitete të përbashkëta edhe për çështje të tjera të cilat shkojnë për të mirë të fshatit.

Qasja:

Sipas idesë së këtij projekti do të ndërtohet një objekt sportiv, fushë për mini futboll në një hapësirë publike të fshatit në madhësi të fushave për futboll të vogël. Fusha do shtrohet me bazament të tokës pasi gropohet kodra bëhet nivelimi i fushës dhe rrethohet fusha.

Titulli i projektit: Rregullimi i kanalizimit të fshatit

Spektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 6 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Videjë, Klinë

Buxheti: 60 000Å

Qëllimi i projektit:

Më këtë projekt synohet që të ofrohen kushte më të mira për banorët e këtij fshati, si dhe të zgjidhet problemi i ujërave të zeza dhe parandalimin infeksioneve nga kanalizimet aktuale.

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës së fshatit që e eliminon problematikën brengosëse të ujërave të zeza
- Krijimi i një ambienti të pastër dhe të shëndoshë për jetesë
- Krijimi i kushteve më të mira për jetë të komunitetit me kyçjen e rregullt në kanalizim

Përfituesit:

Përfitues të këtij projekti janë banorët e fshatit ku jeton komuniteti në përgjithësi në këtë fshat, përfshirë komunitetin serb por edhe komunitete tjera

Qasja:

Me këtë projekt parashihet ndërtimi i rrjetit të kanalizimit për banorët e fshatit. Rrjeti do shtrihej përgjatë dy rrugëve të fshatit dhe përfundon në rrjetin e kanalizimit të qytetit. Gjatësia e rrjetit të kanalizimit është përafërsisht 1.5 kilometra.

Titulli i projektit: Ndërtimi i një Shtëpie kulture për fshatin

Sektori: Kulturë

Afati kohor: për 6 muaj (duke filluar nga viti 2013)

Vendi: Vidëjë, Klinë

Buxheti: 40 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Ky projekt ka për qëllim krijimin e një hapësire të pajisur dhe të rregulluar për aktivitete të ndryshme kulturore, argëtuese e tjera, që do të zhvillohen nga gratë, të rinjtë si dhe grupmoshat e tjera në komunitetin e fshatit.

Objektivat:

- Sigurimi i një objekti kulturor për komunitetin
- Krijimi i një hapësire që korrespondon me nevojat e shumta të rinjve
- Sigurimi i një ambienti për gratë që merren me aktivitete tradicionale si punë dore e tjera
- Krijimi i një hapësire për komunitetin për nevojat e ndryshme të popullatës vendore

Përfituesit:

Nga ky projekt do të përfiton komuniteti i kthyer, që graviton më një masë më të madhe në këtë fshat. Po ashtu përfitues janë të gjitha grupmoshat e ndryshme që janë të përfshira po edhe të përfaqësuara në këtë fshat. Këtu përfitojnë edhe disa familje të komuniteteve tjera që jetojnë në këtë fshat.

Qasja:

Objekti i ri do ndërtohej në një hapësirë publike që ndodhet në qendër të fshatit, e cila do shfrytëzohej për objekt kulture për nevojat e komunitetit të fshatit. Me këtë projekt do të ndërtohej njëkatësh me 100 metra katrore ndarë në disa hapësira sipas destinimit.

8. Fshati Grabc

Fshati Grabc para luftës ka qenë i banuar me 44 shtëpi me përafërsisht 130 anëtarë të komunitetit serb si dhe 12 familje shqiptare, të cilët janë dyfishuar gjer më tani.

Aty banon edhe një numër i vogël prej disa familjesh egjiptiane. Gjatë vitit 2002 ka filluar kthimi në këtë fshat, organizata THW ka ndërtuar 28 shtëpi në të cilat banorë të përhershëm që jetojnë aty janë përafërsisht 30 anëtarë.

Grabci kufizohet me fshatrat Jashanicë, Krnjinë, Shtupel dhe Binçë. Dikur kishte të dhjetëra të punësuar në institucione dhe ndërmarrje të Klinës, ndërsa një numër i këtyre banoreve punonte në Beograd, Kragujevc si dhe në qytete tjera të Serbisë.

Nga donacionet e pasluftës përveç në ndërtimin e shtëpive, kane edhe një pjesë të mjeteve bujqësore të dhuruara nga donatorë të ndryshëm. Nga donacionet e Organizatës IOM ky fshat ka përfituar një dyqan dhe një cirkular me shume operacione. AKTED për gjysmën e fshatit ka dhuruar nga diçka: pula, derra, lope, etj. Manastiri i Deçanit ka dhuruar një traktor me disa pjesë përcjellëse.

Deri në fund të vitit 2009 aty ka qenë e vendosur baza e KFOR-it, e cila përveç sigurisë së këtyre banorëve u ka siguruar edhe disa beneficione si çështjen e ujit, energjisë elektrike si dhe mjeteve tjera

Titulli i projektit: Riparimi i rrjetit elektrik në fshat

Spektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Grapc, Klinë

Buxheti: 10 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Zëvendësimi i shtyllave elektrike si dhe rrjetit të telave të vjetruara që vazhdimisht krijojnë pengime në furnizim të rregullt të kësaj popullate që ballafaqohet vazhdimisht më prishjet e ndryshme serioze në sistemin elektrik e që vazhdimisht krijojnë djegie të aparateve në amvisëri.

Objektivat:

- Eliminimi i problematikave të ndryshme nga prishjet e shpeshta në rrjetin furnizues më rrymë
- Eliminimi i rreziqeve që krijojnë shtyllat e rrezuara në rrugët qarkulluese si dhe në pjesët e fshatit ku rrezikohen këmbësorët
- Furnizimi i rregullt dhe i sigurt me rrymë elektrike

Përfituesit:

Përfitues do të jetë komuniteti serb i kthyer në fshatin Grapc e që me këtë problematikë përballet nga kthimi i vitit 2002 e deri më tani. Përfitues të drejtpërdrejtë janë edhe pjesëtarë të komuniteteve tjera që jetojnë në fshat.

Qasja:

Me këtë projekt është paraparë ndërimi i shtyllave dhe telave përgjatë rrjetit të fshatit në gjatësi prej 500 metra nga lidhja në fund të fshatit Shtupel përgjatë gjithë fshatit.

Titulli i projektit: Rregullimi i pompës së ujësjesit

Spektori: Infrastrukturë

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2012)

Vendi: Grapc, Klinë

Buxheti: 12 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Riparimi i pompës që sjell ujin e pijes për banorët e fshatit Grapc, e cila ka kohë pasi që është dëmtuar nuk furnizon fshatin me ujë.

Objektivat:

- Eliminohen reduktimet e ujit të pijshëm në fshat duke u përmirësuar jeta e përditshme në një gjendje më të kënaqshme.
- Përmirësohet furnizimi i ujit të pijshëm dhe krijohen kushtet më të mira për komunitetin serb
- Përmirësohet gjendja aktuale në aspektin shëndetësor, ambiente, bujqësor, social.

Përfituesit:

Më këtë projekt përfiton komuniteti i kthyer ku përfshihen gjitha grupmoshat më theks të veçantë që në këtë fshat është një numër më i të moshuarve.

Qasja:

Projekti parasheh blerjen dhe instalimin e pompës që ka për qëllim të bartë ujin nga ujësjesit i qytetit dhe ta orientojë në drejtim të lartësisë në të cilën ndodhet rezervuari i fshatit. Objekti për vendosjen e pompës dhe gjithë rrjeti i ujësjesit është i gatshëm, kërkohen vetëm blerja dhe instalimi i saj.

Titulli i projektit: Asfaltimi rrugës së fshatit

Sektori: Infrastruktura

Afati kohor: 3 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Grapc, Klinë

Buxheti: 10 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Projekti ka për qëllim që të përmirësojë qarkullimin e vështirë të makinave për fshatin, pasi që rruga ekzistuese është shumë dëmtuar dhe qarkullimi zhvillohet me vështirësi për veturat e vogla .

Objektivat:

- Rregullimi i infrastrukturës rrugore dhe krijimi i qasjes normale në fshat
- Përmirësimi i kushteve për jetë për banorët e fshatit
- Përkrahje për kthimin dhe integrimin për banorët e fshatit

Përfituesit:

Me këtë projekt përfiton komuniteti serb i fshatit Grapc që ka lidhje shumë të keqe rrugore për shkak të infrastrukturës rrugore tejet të konsumuar dhe të dëmtuar me vite. Përveç komunitetit serb përfitojnë edhe komunitete tjera që jetojnë në këtë zonë dhe që shfrytëzojnë rrugën.

Qasja:

Me këtë projekt ndërtohet rruga për fshatin Grapc, nga udhëkryqi në dalje nga Shtupeli deri në fund të fshatit. Rruga është rrugë lokale në gjatësi prej 500 metra.

Titulli i projektit: Ndriçimi i fshatit

Sektori: Infrastruktura

Afati kohor: 2 muaj (duke filluar nga viti 2011)

Vendi: Grapc, Klinë

Buxheti: 6 000 Ä

Qëllimi i projektit:

Instalimi i ndriçimit në fshatin Grapc duke përfshirë hyrjen dhe brendësin e fshatit.

Objektivat:

- Rritja e nivelit të sigurisë në komunikacion rrugor për nxënës kalimtar nga makinat dhe nga qentë endacak
- Avancimi i infrastrukturës rrugore për komunitetin vendas
- Krijimi i parakushteve dhe ndjenjës për siguri fizike të të kthyerve
- Ngritja e sigurisë në aspekte të ndryshme

Përfituesit:

Më përfitues direkt janë komuniteti i kthyer ku kryesisht jetojnë familjarë në moshë të shtyrë.

Qasja:

Me këtë projekt parashihet ndërtimi i rrjetit elektrik ndriçues me shtylla për fshatin nga hyrja deri në brendësi të fshatit në gjatësi rreth 400 metra.

IV. Buxheti



Buxheti:

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Koha/ muaj	Euro	Totali në EURO
1	Edukim dhe Rini				2,000.00
1.1	Fshati Videjë				2,000.00
1.1.1	Ndërtimi i një fushe për minifutboll	1	3	666.67	2,000.00
2	Punësimi dhe zhvillimi ekonomik				394,000.00
2.1	Qyteti Klina				93,000.00
2.1.1	Asfaltimi i rrugës "Marie Shllaku"	1	2	15,000.00	30,000.00
2.1.2	Kanalizimi i ujërave të zeza	1	3	5,000.00	15,000.00
2.1.3	Kanalizimi i ujërave atmosferike	1	2	10,000.00	20,000.00
2.1.4	Ndërtimi një depoje për mjete bujqësore	1	2	14,000.00	28,000.00
2.2	Fshati Dersnik				70,000.00
2.2.1	Rregullimi i rrjetit elektrik	1	3	3,333.33	10,000.00
2.2.2	Kanalizimi i ujërave të zeza	1	3	20,000.00	60,000.00
2.3	Fshati Binçë				21,000.00
2.3.1	Zëvendësimi i rrjetit elektrik	1	1	15,000.00	15,000.00
2.3.1	Rregullimi i rrugës së fshatit	1	2	3,000.00	6,000.00
2.4	Fshati Berkovë				27,000.00
2.4.1	Ndriçimi rrugor i fshatit	1	1	12,000.00	12,000.00
2.4.2	Rregullimi i rrugës së kodrës	1	2	4,000.00	8,000.00
2.4.3	Asfaltimi i rrugës së varrezave	1	2	3,500.00	7,000.00
2.5	Fshati Rudicë				48,000.00
2.5.1	Pastrimi i shtratit të lumit	1	1	8,000.00	8,000.00
2.5.2	Ujësullësi i fshatit	1	6	5,000.00	30,000.00
2.5.3	Rruça Rudicë- Bërkovë	1	6	1,666.67	10,000.00
2.6	Fshati Dollc				37,000.00
2.6.1	Përkrahje për objektet ndihmëse në fshat	1	3	666.67	2,000.00
2.6.2	Instalimi i ndriçimit rrugor	1	2	5,000.00	10,000.00
2.6.3	Rregullimi i rrugës së fshatit	1	2	5,000.00	10,000.00
2.6.4	Rregullimi i kanalit të ujitjes	1	3	5,000.00	15,000.00
2.7	Fshati Videjë				60,000.00
2.7.1	Rregullimi i kanalizimit të fshatit	1	6	10,000.00	60,000.00
2.8	Fshati Grapc				38,000.00
2.8.1	Riparimi i rrjetit elektrik	1	3	3,333.33	10,000.00
2.8.2	Rregullimi i pompës së ujësullësit	1	3	4,000.00	12,000.00
2.8.3	Asfaltimi i rrugës së fshatit	1	3	3,333.33	10,000.00
2.8.4	Ndriçimi i fshatit	1	2	3,000.00	6,000.00
3	Shëndetësia dhe çështjet sociale				40,000.00
3.1	Fshati Dersnik				20,000.00
3.1.1	Ndërtimi i rezervoarit për ujë të pijshëm	1	2	10,000.00	20,000.00
3.2	Fshati Dollc				20,000.00
3.2.1	Restaurimi i rezervoarit të ujit të pijshëm	1	2	10,000.00	20,000.00
4	Kultura				165,000.00
4.1	Fshati Binçë				40,000.00
4.1.1	Renovimi i shtëpisë së kulturës	1	6	6,666.67	40,000.00
4.2	Fshati Dersnik				40,000.00
4.2.1	Renovimi i shtëpisë së kulturës	1	6	6,666.67	40,000.00
4.3	Fshati Berkovë				15,000.00
4.3.1	Renovimi i shtëpisë së kulturës	1	6	2,500.00	15,000.00
4.4	Fshati Dollc				30,000.00
4.4.1	Renovimi i shtëpisë së kulturës	1	6	5,000.00	30,000.00
4.5	Fshati Videjë				40,000.00
4.5.1	Ndërtimi i një shtëpie kulture për fshatin	1	6	6,666.67	40,000.00
	Overall Total (1+2+3+4)				601,000.00

Parashikimi i buxhetit në këtë pasqyrë financiare i referohet vetëm pjesës së tretë, ndërhyrjes me projekte në komunitet. Pjesa e dytë në të cilat hyjnë iniciativat dhe rekomandimet nuk është buxhetuar, për shkak se autorët e strategjisë mendojnë se këto rekomandime mbesin orientime të vazhdueshme për punën me komunitetin.

V.
Foto







